



22-04-2021
02/2021



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/_____

Datë: 20.04.2021

PROCESVERBAL

i mbledhjes së nëntë (IX) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

R E N D I D I T Ë S

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së shtatë (VII) të vitit 2020.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021.
3. Raporti i Drejtorisë së Urbanizmit lidhur me realizimin e projekteve kapitale për vitin 2020.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2021.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1154 datë: 11.11.2020 të parashtruar nga kryetari i komunës, për vazhdimin e shërbimeve të varrimit për banorët e komunës së Malishevës për vitin 2021.
6. Rishqyrtimi i vendimit nr.02/473 datë: 03.12.2020, sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-945/9 datë:11.12.2020, për dhënien në shfrytëzim të pronës publike KEDS-it, për vendosjen e re të stabilimenteve të nevojshme energjetike.
7. Rishqyrtimi i vendimit nr.02/412 datë: 03.11.2020, sipas raportit të vlerësimit të MAPL-së nr.020-839/12 datë:27.11.2020, për caktimin e lokacionit për vendosjen e pikës së transferit, për grumbullimin, transportimin, depozitimin e mbeturinave (jo të ngurta) të cilat grumbullohen nga (K.R.M) Ekoregjioni Sh.a në Prizren, njësia në Malishevë.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës nr.02/493 datë: 04.12.2020 të Komitetit për Barazi Gjinore për vitin 2020.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit të punës nr.02/509 datë: 09.12.2020 të Komisionit Komunal të Aksionarëve për vitin 2021.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.12/227 datë: 10.12.2020 të parashtruar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për miratimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal 2021-2023.
11. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/503 datë: 07.12.2020 të parashtruar nga N.T.P "ILI", nga fshati Banjë, për lirim nga pagesa e këstit të katërt të shfrytëzimit të Pishinës Publike në fshatin Banjë.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave të qytetarëve të Komunës së Malishevës, për meremtim dhe renovim të shtëpive:
 - a.Kërkesa nr.01/534 datë: 17.06.2020 e parashtruar nga z.Ali Paqarizi nga fshati Lubizhdë, për ndihmë me rastin e djegies së shtëpisë së banimit nga zjarri.
 - b. Kërkesa nr.01/873 datë: 07.09.2020 e parashtruar nga z. Brahim Hoxha nga fshati Guncat, për ndihmë me rastin e djegies së shtëpisë së banimit nga zjarri.
 - c. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës 02/515 datë:14.12.2020 të parashtruar nga Muharrem Morina nga fshati Astrazup, për ndihmë financiare për meremetim të shtëpisë.
 - ç. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës 02/505 datë: 08.12.2020 të parashtruar nga Nebih Zogaj nga fshati Lladroc, për ndihmë financiare për renovimin e shtëpisë së djegur nga zjarri.
 - d. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/524 datë:16.12.2020 të parashtruar Zenel Thaqi nga fshati Mirushë, për ndihmë financiare për meremetim të shtëpisë.
13. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të grupit të grave asambleiste.
14. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 23.12.2020 dhe filloi në ora: 10:30. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 18 asambleistë, drejtorë komunalë dhe zyra për informim.

Rrahim Morina: Përshëndetje për të gjithë! E hapi mbledhjen e nëntë (IX) të rregullt për këtë vit. Të pranishëm jemi 18 asambleistë, dhe po i lexoj emrat e atyre që kanë lajmruar që nuk kanë mundur të vijnë: Ilaz Krasnqi dhe Nebih Bibaj. Për të tjerët që mungojnë nuk kam asnjë informacion.

Më lejoni që në emrin tim dhe tuajin, bashkatdhetarëve t'u dëshiroj mirëseardhje dhe pushim sa më të mirë pranë familjeve të tyre, shokëve dhe dashamirëve! Kjo është mbledhja e fundit për këtë vit, dhe besoj që si kuvend i kemi përmbushur detyrat tona. Me përpikëri është votuar plani i punës, dhe ju falenderoj për kontributin që e keni dhënë gjatë këtij viti! Një çështje desha ta sqaroj paraprakisht. Kemi shumë pika jashtë rendit të ditës, nëse keni mundësi t'i përmbaheni rregullores që është 30 minuta, dhe të shkojmë menjëherë në pika të rendit të ditës. Para se të shkojmë te pika jashtë rendit të ditës, fjalën i'a përcjellë Vera Bytyçi, e cila ka përgaditur një boletin në pika të shkurtëra. Kjo është bërë dhe në pajtim me shefat e grupeve. Urdhëro, Vera!

VeraBytyçi: Përshëndetje për gjithë të pranishmit! Të nderuar asambleistë, kryesues dhe ju drejtorë! Kam nderin dhe respektin që para jush ta bëj prezantimin e buletinit informues nga Zyra për Barazi Gjinore, duke falënderuar kryetarin për përkrahje, dhe duke i uruar shërim sa më

të shpejtë. Gjithashtu, falënderoj të gjithë anëtarët e asamblesë komunale për bashkpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme, që e kanë bërë në raport me Zyrën për Barazi Gjinore. Duke i ngritur dhe inicuar çështjet e ndryshme për të ecur përpara proceseve, të cilat ndërlidhen me çështje gjinore, respektivisht balancën gjinore. Buletini informative, përmban përfshirjen e disa aktiviteteve të realizuara për vetëdijësim dhe sensibilizim: bashkëpunimet, përkrahjet, të dhënat statistikore në baza gjinore, e kështu me radhë. Ne si zyrë, edhe në të ardhmen shpresojmë në bashkpunimin tuaj, sikursegjerë tani. Ju falënderoj për kohën dhe mundësinë, punë të mbarë dhe suksese!

Rrahim Morina: Faleminderit, Vera edhe ne të falënderojmë ty për kontributin që e ke dhënë! Hapim debat për pikën jashtë rendit të ditës. Sylë Dukolli e ka fjalën.

Sylë Dukolli: Faleminderit, Kryesues! Përshëndetje kolegë dhe ju pjesëmarrës! Është fundi i vitit, dhe për fat të mirë po na vijnë mërgimtarët, uroj që të kalojnë mirë me familjarët e tyre, të kenë përkrahje edhe institucionale në kryerjen e shërbimeve të tyre, që u duhen për vendet kur të kthehen. Unë në takimin e mbledhjes së kaluar nuk kam qenë, lutemi për shëndetin e kryetarit të komunës z. Ragip Begaj, që sa më shpejtë të shërohet dhe t'i kthehet punës.

Shqetësuese këto ditë janë ndaljet e shpeshta të energjisë elektrike. Realisht nuk ka ditë që nuk përballemi me reduktime të energjisë elektrike. Andaj një mesazh për KEDS-in, e di që komuna nuk po mund të ketë ndikim në atë që të na kursej nga reduktimet, pasi që edhe verës nuk po e jep atë energji të cilën e kërkojnë shërbimet tona familjare dhe bizneset.

Një dukuri tjetër negative, që nuk është vetëm në Malishevë, por në gjithë Kosovën, janë qentë endacakë. Qentë endacakë po rrezikojnë fëmijët, pleqtë dhe njerëzit që po lëvizin, pasi që është shtuar numri i tyre. Kisha kërkuar që drejtoria përkatëse, ta ketë një vëmendje më të përqendruar, t'i kufizojnë, mbase nuk mund t'i asgjësojnë. Ju falënderoj për bashkëpunimin gjatë gjithë vitit!

Rrahim Morina: Urdhëro, Alban!

Alban Krasniqi: Faleminderit, Kryesues! Fillimisht ju uroj të gjithëve shpalljen e zgjedhjeve të reja, në të njëjtën kohë dhe festat e fundvitit! I bashkohem parafolësit, mbi çështjet që i ngriti, sa i përket KEDS-it por, edhe qenëve endacakë. Mbi të gjitha i bashkohem parafolësit edhe për urimin që e pati, që kryetari Begaj të kthehet sa më shpejtë pranë detyrës së tij. Mirëpo, në anën tjetër, kërkoj dhe një transparencë më të madhe nga zyra e kryetarit, mbi gjendjen e tij, mbi mundësinë ose pa mundësinë e ushtrimit të detyrës së tij, në mënyrë, që pastaj e ushtron detyrën nënkryetari në bazë të legjislacionit. Ne, si asamble komunale, por mbi të gjitha, qytetarët duhet të jenë të informuar mbi shëndetin e kryetarit. Qytetarët le ta

shohin që përveç një drejtori komunal, asnjë përfaqësues tjetër i ekzekutivit nuk është prezent, mbi të gjitha nënkryetari, dhe ne nuk e dimë se kujt do t'i drejtohem për çështjet që do t'i ngrisim tani. Pra, mungesa e kryetarit, ndonëse edhe kur ka qenë kryetari prezent në ushtrimin e detyrës, kjo ka qenë e evidente. Mirëpo, përmasat të cilat po shfaqen tash për mua janë shqetësuese. Sepse është shpërfillje ndaj shumë çështjeve, që i kemi në rend të ditës, është shpërfillje dhe ndaj votës së qytetarëve që e kanë marrë. Është shpërfillje ndaj legjislacionit, ligjit, kushtetutës, dhe ndaj të gjithë atyre akteve ligjore dhe nënligjore, që i përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e ekzekutivit, të kryetarit dhe ushtruesit të detyrës së kryetarit, që kanë ndaj qytetarëve. Përgjegjësinë për raportim ndaj kuvendit komunal, përgjegjësitë për t'iu përgjigjur çështjeve që ne do t'i shqyrtojmë, përgjegjësitë ndaj kërkesave që vet ekzekutivi i ka sjellur te ne për t'i shqyrtuar, dhe kjo për mua është shqetësuese.

Unë e kam një çështje, që e kanë ngritur qytetarët dhe e kanë adresuar tek unë, të cilën e kam obligim që ta paraqes si problem. Me datë: 7.10.2020 Drejtoria për Bujqësi ka bërë një shpallje për subvencionim, ndihmë për dy stalla, për lopë qumështore dhe një stallë për dele ose dhi. Dhe, në një njoftim që komuna e ka pasur para pak ditësh, ne e kemi parë që kjo stalla për dele ose dhi ka filluar të ndërtohet në fshatin Gurbardh, nëse nuk gaboj, mirëpo ne nuk kemi parë asnjë shpallje me listën e aplikuesëve dhe përfituesëve të atyre që kanë përfituar. Pra, që në fillim shihet mungesa e transparencës nga Drejtoria e Bujqësisë, dhe kjo nuk është diçka e re për ne. Ajo çka më shqetëson më së shumti, është që ky proces është përcjellë me shkelje të shumta, dhe kam informacione të besueshme nga brenda komunës, që është vëllai i drejtorit të urbanizimit, njëri nga përfituesit e fermës së lopëve. Do të ishte në rregull, nëse procesi do të ishte transparent, dhe qytetarët të kenë mundësi të shohin se kush ka aplikuar, dhe kush i ka plotësuar kriteret. Një prej kriterëve thotë, që duhet t'i kenë rreth 10 krerë lopë, dhe as këtë kriter nuk e plotëson familjari i drejtorit të urbanizimit. Në të njëjtën kohë, jam interesur të pyesë, nëse është bërë pagesa nga banka në këtë 30%, dhe merreni me mend asambleistë të nderuar, meqenëse janë dy stalla, njëri nga përfituesit e stallës, familjari i drejtorit të urbanizimit, as që ka aplikuar për stallë, dhe familjari i drejtorit të urbanizimit, përfituesi i kësaj është 17.000 €. Më tregoni ju, që ka qenë i rastësishëm dhe transparent procesi, kur nuk janë shpallë emrat, as të aplikuesëve as të përfituesëve, dhe kjo për mua ngreh dyshime. Pra, kemi një shpallje për t'i ndihmuar fermerët, e cila përfundon në ndihmë familjarëve të disa pushtetarëve të NISMA-s. Unë kisha kërkuar publikisht nga nënkryetari i komunës, nga Drejtoria e Bujqësisë, që deri sa ne jemi në mbledhje këtu, të vijnë dhe të na vënë në dispozicion dokumentet që vërtetojnë që personi në fjalë, ka aplikuar si të tjerët, dhe personi në fjalë, e ka bërë pagesën prej 5.000 € që është e përcaktuar, të sjellë kontratën dhe listën. Çdo ditë e më shumë po keqpërdoret paraja publike, 17.000 € po i shkojnë në xhep një familjari të ngushtë të një zyrtari komunal dhe kjo duhet të ketë vëmendje dhe të institucioneve të drejtësisë. Kërkoj transparencë, llogaridhënje nga nënkryetari, nga

Drejtorja e Bujqësisë, për rastin në fjalë, sepse rasti i dytë nuk ka mundur të jetë përfitues, sepse nuk ka mundur t'i siguroj 5.000 € dhe ka hequr dorë, kurse rasti në fjalë as që e ka bërë pagesën. Faleminderit!

Rrahim Morina: Urdhëro, Sadije!

Sadije Krasniqi: Faleminderit, Kryesues! Përshëndetje drejtorë, anëtarë të kuvendit, dhe të gjithë ju të pranishëm në sallë! Shqetësimi im për sot janë ndaljet e shpeshta të energjisë elektrike dhe ndërprerjet e shpeshta të ujit të pijes, që këto ditë e kanë vështërsuar punën e bizneseve dhe jetën e qytetarëve. Shqetësim tjetër, janë disa gropa afër rrugës “Medlin Olbrajt”, që ka kohë që janë aty, dhe nuk po ndërmerret asgjë. Kërkoj që të rregullohen ato gropa. Gjithashtu, afër shkollës është një pusetë, kapaku i së cilës sa herë kalojmë aty, bënë një zhurmë shumë të madhe, dhe është shqetësim i banorëve të cilët jetojnë aty, dhe ka qenë kërkesa e tyre që të rregullohet. Faleminderit!

Rrahim Morina: Urdhëro, profesoreshtë!

Hidajete Mazreku: Faleminderit, Kryesues! Përshëndetje drejtorë dhe ju kolegë asambleistë! Pasi është fundi i vitit, dhe kemi ardhjen e shumë mërgimtarëve, unë u dëshiroj pushim të këndshëm pranë familjes dhe miqve të tyre. Njëkohësisht i dëshiroj shërim të shpejtë kryetarit Ragip Begaj, dhe të kthehet sa më shpejtë në detyrat e tij.

Shqetësimi i qytetarëve është biblioteka e qytetit që nuk funksionon, posaçërisht gjatë kohës së dimrit. Energjia elektrike vitin e kaluar ka funksionuar vetëm disa muaj, dhe këtë vit nuk është duke funksionuar. Kur ne ua mbylлим një derë qytetarëve, nxënësve, ku stimulohet dija në bibliotekën e qytetit të Malishevës. Atëherë, ku ata do të krijojnë dituri, ku do të arsimohen dhe ku do t'i gjejnë librat që duhet t'i mësojnë, që duhen dhe për shkollat e mesme, edhe për shkolla profesionale dhe universitare. Kisha lutur nënkryetarin si drejtues të detyrës, që të shikojë bashkë me KEDS-in, se ku është defekti i energjisë elektrike së bibliotekës së qytetit. Pse nuk kemi nxemje në sezonin ku më së shumti i nevojitet bibliotekës. Shqetësimi tjetër, është pse të gjitha komunat kanë energji elektrike. Pse Malisheva nuk ka energji elektrike, ditën nga 2 orë dhe në mbrëmje nga 2-3 orë. E lus ushtruesin e detyrës së kryetarit, le të bisedojë me KEDS-in, dhe të bëjë një marrveshje me ta, dhe të dalin me një komunikatë, pse ka ndodhur kjo, ku është prishja dhe a do të bëhet evitimi. Dje mbajta komisionin për komunitete, një shqetësim të madh kishin edhe anëtarët e komitetit për komunitete. Të gjitha rekomandimet në këtë vit që kanë dalur nga komiteti për komunitete, asgjë nuk është realizuar. Posaçërisht, Muharremi kishte një shqetësim prej vitit 2018 ka bërë kërkesë për dyer, dritare dhe për kulm, mirëpo asgjë nuk është bërë sot e asaj dite. Ju faleminderit!

Rrahim Morina: Halil Morina e ka fjalën.

Halil Morina: Faleminderit, Kryesues! Të nderuar drejtorë, të nderuar kolegë asambleistë! Po e shfrytëzoj rastin të flas për shqetësimet që u ngritën këtu në lidhje me keqpërdorimet me subvencione. Në parim, ne e dimë që kur hapet një konkurs për subvencionim, kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë qytetarët e komunës së Malishevës, pa marrë parasysh familjari i kujt është. Unë aq sa kam informacione, për subvencionim për stalla, kanë aplikuar vetëm dy persona në komunën e Malishevës, dhe kanë pasur të jepen veç dy stalla. Personi për të cilin u fol këtu, unë e di që ai merret me blegtori, ka mbi 10 krerë lopë, nuk e di pjesën tjetër se a e ka paguar apo jo, mirëpo nuk mund t'ia mohojmë, pse është familjar i dikujt në pozicion brenda komunës. Për çështjet e tjera jam kundër, çdo lloj shkelje ose diskriminimi sa i përket çfarëdo lloj subvencionimi apo çfarëdo lloj forme që komuna i ndihmon ndokujt. Pra, këtu 2 persona kanë aplikuar dhe të dy kanë përfituar. Nuk ka këtu diskriminim, të thuhet që e ke eliminuar dikë për t'ia dhënë dikujt të një familjari. Faleminderit!

Rrahim Morina: Alban Mazreku e ka fjalën.

Alban Mazreku: Përshëndetje për të gjithë! Unë po i dëshiroj mirëseardhje të gjithë mërgatës sonë, të cilët gjatë verës nuk mundën të vijnë në vendlindjen e tyre, dhe në emër të grupit parlamentar të PDK-së, kryetarit të komunës i dëshiroj shërim të shpejtë. Sa i përket energjisë elektrike është e çuditshme, që nëse e thirr numrin e KEDS-it, aty thotë se ka prishje, për çdo ditë thotë ka prishje, por realisht nuk ka prishje, por, ka ndërprerje. Nuk e di, a e kanë këtë të qëllimshme apo jo, ose për t'i ruajtur ato stabilimentet e veta që janë në komunën e Malishevës, që është rrjeti i stërmgarkuar dhe i stërvjetruar.

Sadija e përmendi rrugën “Medlin Olbrajt”, mirëpo është një çështje që e kam ngritur shpesh këtu, besoj drejtori Blerim, e di që në hyrje të shkollës fillore “Ibrahim Mazreku”, ajo grope është shumë problematike dhe ka gati një vit. Rruga “Ibrahim Mazreku” është interesante që para dite e rregullon Drejtoria e Urbanizmit, ndërsa pasdite ujësjellësi i ‘mëshon’ nga të dojë aty, dhe nuk merr përgjegjësi për ta kthyer në gjendjen e mëparshme. Këtë kërkesë e ka pasur dhe Drejtoria e Urbanizmit, sepse duhet pasur parasysh aty ku i dëmton rrugët ujësjellësi, duhet t'i kthejë në gjendjen e mëparshme. Të njëjtin rast e kanë dhe te rruga “Lufëtarët e UÇK-së”, që gjendet në lagjen Hysenaj dhe askush nuk është marrë me atë çështje. Rruga “Skenderbeu” që është duke u ndërtuar, është në gjendje të mjerueshme për momentin, mirëpo dhe ndërtimi i saj, nuk është bërë me standard të kërkuara nga drejtoria e urbanizimit. Kompania që është duke punuar aty ka për të fituar për vete, e ne po na lë punën e keqe këtu. Kryesues, nuk e di a e ke pasur një kërkesë të lagjes së Matoshëve të Fazli Mazrekut, Mevledin Mazrekut e kanë një kontekst në lagjen e Hotve të varrezat, nuk e di a ka ardhur, sepse ne si asamble nuk e kemi pasur asnjëherë në dorë për ta debatuar atë çështje, sepse ka qenë një situatë e tensionuar. Kështu që, është mirë të debatohet dhe të gjendet një zgjidhje në mes atyre dy lagjeve. Faleminderit!

Rrahim Morina: Alban, këtë kërkesë e kemi shqyrtuar në komitetin për Politikë dhe Financa dhe për shkak të situatës së krijuar atje për mendim timin, nuk kanë dashur që ta nxisin dhe më shumë këtë konflikt. Ata e kanë bërë kërkesën në gjykatë për pushimin e punimeve, dhe aty ku lënda shkon në gjykatë, kuvendi nuk ka mundësi të merret më me atë çështje. Ne urojmë që të dy palët të ulen, dhe të merren vesh në mes vete me ndonjë ndërmjetësues, sepse ata kanë kërkuar anulimin e vendimit, dhe anulimi i vendimit shkakton probleme dhe më të mëdha. Lënda ka shkuar në gjykatë, dhe ne u jemi përgjigjur me shkrim për qëndrimin e KPF-së. Ata pretendojnë se toka është e tyre, dhe ne e kemi lëshuar një rrugë, vendimi është i kuvendit, dhe si do që të jetë gjykata vazhdon më tutje.

Kalojmë për pikën e rendit të ditës. Ndërkohë, kanë mbërritur dhe pika që unë do t'i lexoj dhe po kërkojë që këto pika të futen në rend të ditës, për shkak se janë më tepër raporte të punës së komisioneve dhe planeve të veprimit.

Kërkesa 1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/529 datë:18.12.2020 e parashtruar nga Alban Krasniqi, anëtar i kuvendit komunal nga radhët e Lëvizjes Vetvendosje, lidhur me vendimin për ndarjen e pakove financiare për bizneset e vogla të prekuara nga masat restriktive dhe kriza e shkaktuar nga pandemia Covid-19.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të veprimit për vitin 2020 të Komitetit të Familjëve të Dëshmorëve.

3. Shqyrtimi i raportit të punës i Komitetit për Arsim, Rini, Kulturë dhe Sport.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së parashtruar nga Afrim Robaj nga fshati Astrazup për ndihmë në meritimin e shtëpisë, dhe

5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2021.

Hapim debat rreth kësaj çështjeje. Avdi Morina e ka fjalën.

Avdi Morina: Përshëndetje të nderuar kolegë! Kryesues, së pari po ta tërheq vërejtjen, sepse nuk je zot këtu, janë disa rregullore të cilat e përcaktojnë të drejtën e secilit për ta shprehur mendimin e tij këtu në foltore. Unë jam që rregullat të respektohen në mënyrë strikte, por duhet të respektohen për të gjithë njësoj. Unë po e shfrytëzoj rastin që të ndërlidhem me disa çështje, që duhet t'i ceku, pajtohem me parafolësit e mi, që kemi probleme me reduktime të energjisë elektrike, dhe në bazë të kontaktit që kemi pasur me zyrtarët e KEDS-it, thuhet se nuk është faji i KEDS-it, por është faji i kostit. KEDS-i sa i përket furnizimit me energji elektrike, thotë se energji elektrike ka të mjaftueshme, por për shkak që Malisheva ka mungesë të 110 kilovatëshit që nuk e ka, po duhet të ballafaqohet me këtë situatë. Nëse pajtohen grupet politike, pas pauzës së drekës ta diskutojmë dhe ta bëjmë një kërkesë së bashku. Shqetësimin që e ka ngritur Albani, para tri ditëve, kam biseduar me drejtorin, dhe ishte e vërtetë që ishin dy shpallje për dy stalla përfituese, dhe kanë aplikuar vetëm dy qytetarë, dhe kanë përfutur këta qytetarë që kanë aplikuar.

Rrahim Morina: Urdhëro, Alban!

Alban Krasniqi: Në parim pajtohem me kërkesën e Avdiut, vetëm na duhet një informacion i saktë që mos të dalim keq ne si kuvend. Nëse duam t'i adresojmë, pa problem i adresojmë. Te pjesa e stallave, vetë fakti që dy persona kanë aplikuar, nuk ka pasur më shumë, për mua është mëse e qartë, sepse as në buxhet nuk kanë qenë për lopë, kanë qenë për dhi e dele e të cilave ua kemi dedikuar ato. Në parim jam që dhe kërkesat e tjera të futen në shqyrtim, ndonëse një pjesë të tyre do t'i futim në grupin kërkesat, p.sh. ajo kërkesë që është dyer e dritare hynë në ato kërkesa, që janë për shtëpi dhe besoj aty do të dalim me një propozim. Edhe propozimin që e kam bërë, i kam futur në fokus, i kam parë më detajisht dokumentet, mundësitë dhe kam ardhur me një kërkesë si asambleist, dhe në parim, kemi qenë pro që të ndihmohen bizneset që kanë vuajtur më shumë prej Covid-19, prej masave që kanë pasuar, qoftë prej nivelit qendror apo lokal. Ne e kemi një kërkesë për t'i ikur këtij trajtimi selektiv. Unë mendoj që duhet ta marrim një vendim të përgjithshëm, sepse kemi qindra biznese që vuajnë mbiejtesën, që e kanë sot për nesër, dhe mbajnë familje me ato biznese, dhe ne jemi të shurdhër ndaj kërkesave të këtyre bizneseve. Pjesë e kërkesës është edhe një borxh i akumuluar tash mbi 800.000 € borxhet që i kanë bizneset. Dhe për këtë borxhin ndaj detyrimeve komunale që i kanë, t'i shohim sepse ka shumë biznese që janë të mbyllura tashmë, dhe ndonëse janë të mbyllura ATK-ja nuk i shlyen, sepse i kanë borxhe dhe ATK-së, por i kanë obligime edhe komunës. Ato si biznese janë inekzistente, nuk ekzistojnë dhe na kanë mbetur si borxh barrë i cili nuk është i akumulushëm, sepse nuk mund ta marrë atë borxh më prej atyre bizneseve. Për këtë arsye propozimi është i qartë. Që të themelohet një komision prej kuvendit dhe ekzekutivit, që do t'i trajtonte kriteret bazë për ndarjen dhe për mënyrën se si duhet aplikuar, për t'i selektuar e përzgjedhur bizneset përfituese që kanë vuajtur prej pandemiesë, por edhe bizneset të cilat mund të përfitojnë nga falja e borxheve që kanë ndaj komunës, borxhe që komuna mund t'i falë, jo për borxhe që janë jashtë sferës së komunës, sepse nuk mundemi me dalë në atë pjesë. Për t'u siguruar për këtë të dytën, duhet ta shikojmë bazën ligjore, por kjo do të duhej të ishte detyrë e komisionit. I kisha lutur të gjithë asambleistët që të jemi bashkë dhe në këtë çështje, se si t'u dalim në ndihmë bizneseve të vogla të prekura nga pandemia, dhe si ta trajtojmë dhe çështjen e borxhit të akumuluar, ku pjesa më e madhe e këtij borxhi tashmë është e pambledhshme, për arsye se ato biznese nuk ekzistojnë, sepse janë të mbyllura dhe formalisht ekzistojnë në regjistër. Ju faleminderit!

Rrahim Morina: Urdhëro, Sylë!

Sylë Dukolli: Kryesues, sa i përket pikave që kanë ardhur shtesë, ndër to dhe kjo për mbështetje financiare. Unë e pashë një shifër që mund të jetë sipas parashatruesit të kërkesës rreth 200.000€, unë nuk i iku asaj anës për t'i ndihmuar bizneset. Ndërsa, sa i përket faljës së atyre detyrimeve që kanë nga

komuna, e që komuna nuk e ka asnjë mjet, mbase janë të falimentuara, as nga ana juridike për t'i mbledhur mjetet, realisht këtë pjesë ky komision mund ta shikojë. Ndërsa, te kjo pjesa e dhënjes së mjeteve, nuk e di këto biznese a kanë mundur të përfitojnë prej pakos së rikëmbjes. Ne më së paku na duhet ta fusim veten në disa kthesa, në të cilat pastaj dëmtohet buxheti i komunës i cili është i detyrueshëm, i ndarë për projekte të caktuara. Unë pajtohem me parafolësin, që ajo pjesë e detyrimeve të këtyre bizneseve që nuk kanë mundur të ushtrojnë veprimtari për shkak të sëmundjes së pandemisë, ky komision nëse janë të pajtimit dhe partitë e tjera mund t'ua falë, sepse komuna mundet t'ua falë detyrimet bizneseve sepse ka vite që nuk e ushtrojnë biznesin. Unë e di, që përveç barnatoreve të cilat e kanë pasur mundësinë për ta ushtruar biznesin dyfish, të gjitha bizneset e tjera janë të dëmturara, i heqim dhe bizneset e shitjes me shumicë, që janë marketet, e që kanë pasur fitim dhe nuk kanë pasur fije solidariteti, sikurse barnaret që çmimet i kanë rritur tri herë më shumë. Për bizneset e tjera, që nuk kanë mundur ta ushtrojnë veprimtarinë, jam që të paktën ndonjë taksë ose diçka që është e mundur t'u hiqet, mirëpo, duhet të shiqohet dhe pakoja e rikëmbjes, se a kanë përfituar nga ky biznes. Unë jam që të gjitha pikat t'i fusim, vetëm t'i sqarojmë dhe mos të gabojmë më vonë, që mos të kemi mundësi ta marrim një raport nga komisioni. Faleminderit!

Rrahim Morina: Në parim po pajtohem. Unë vetëm po e përcjell një kërkesë të Avdi Morinës, që propozoi që të futet një pikë e veçantë e që është shqyrtimi i gjendjes me energji elektrike në komunën e Malishevës. A po pajtoheni, që pika 1 të futet pas pikës "NTP ILI" që është pika nr. 11, raportet të futen te pikat ku i kemi raportet, të gjitha bashkë, kërkesa që ishte për merimetim të futet te kërkesat e merimetimit dhe kjo e KEDS-it të futet në fund.

Kush është për?

Për: 21

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me 21 vota për, asnjë kundër, dhe asnjë abstenim, aprovohet rendi ditës.

Kalojmë në pikën e parë shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë (VII) të vitit 2020. Sylë Dukolli e ka fjalën.

Sylë Dukolli: Unë edhe më parë kam pasur vërejtjet e mia. Kësaj here nuk kam vërejtje në drejtshkrim, madje e falenderoj për drejtshkrimin. Mirëpo, një kërkesë për shtypje e kam, nuk po shihet asgjë dhe nuk po mund ta lexoj. Gjejeni një priter që t'i shtypni si duhet, sepse po kam problem ta lexoj, sepse unë i lexoj procesverbalet. Kërkoj që procesverbali të jetë i pashëm dhe i lexushëm. Faleminderit!

Rrahim Morina: Besoni jemi në gjendje të mjerushme. Nuk punojnë fotokopjet, por duhet që kopjet t'i bëjmë nëpër zyre të tjera. Ministraria e ka marrë furnizimin dhe është shumë i ngadalshëm. Urdhëro, Alban Krasniqi!

Alban Krasniqi: Çështja e materialit me vonesë duhet të shikohet me Drejtorin e Administratës, dhe me ata që merren me shpërndarjen e materialit. Sa i përket procesverbalit, pajtohem me Sylën që jo dukshmëria e procesverbalit, por për t'ua lehtësuar procesmbajtësve, si dokument ndihmës çdo procesverbal ta ketë të bashkangjitur edhe videot me CD, së paku në dosjen tuaj të kuvendit.

Rrahim Morina: Urdhëro, Sadije!

Sadije Krasniqi: Faleminderit, Kryesues! Parafolësit e thanë fjalën e tyre sa i përket dukshmërisë dhe lexueshmërisë së procesverbalit, që është i palexueshëm dhe përveç procesverbalit, pjesa më e madhe e dokumenteve janë të palexueshme. Kisha kërkuar që herën tjetër mos të na vijë ky material, dhe materiali na ka ardhur shumë vonë. Sa i përket procesverbalit, unë kisha kërkuar që procesmbajtëset, respekt për punën e tyre, mirëpo e kam vërejtur që nuk janë përfshirë në procesverbal të gjitha ato çka i kemi thënë ne, dhe kërkoj që herën tjetër të kenë më kujdes dhe të përfshihen të gjitha fjalët, ose gjithë fjalimi çka kam diskutuar këtu. Faleminderit!

Rrahim Morina: Unë dhe një herë po ju kërkoj falje, mirëpo kemi telashe me kopje. Kush është për aprovimin e procesverbalit?

Për : 21

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me 21 vota për, asnjë kundër, dhe asnjë abstenim, aprovohet procesverbali i mbledhjes së shtatë (VII) të vitit 2020.

Kalojmë te pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së kuvendit për vitin 2021. Të gjitha subjektet politike i kanë pasur përfaqësuesit aty dhe nëse pajtoheni shkojmë në votim.

Kush është për miratimin e planit të punës së kuvendit për vitin 2021?

Për: 21

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me 21 vota për, miratohet plani i punës së kuvendit për vitin 2021.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi i raportit të Drejtorisë për Urbanizëm, lidhur me realizimin e projekteve kapitale për vitin 2020. Material nuk kemi, unë përsëri i jam drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit

me shkresë të veçantë, përveç asaj që u kam drejtuar më herët, dhe kam kërkuar që së paku deri me këtë datë të sillet materiali. Unë nuk kam marrë asnjë material. Urdhëro, Alban!

Alban Krasniqi: Ky raport është po aq i rëndësishëm, sepse janë miliona në pyetje, të cilat janë shpenzuar gjatë këtij viti nga Drejtoria e Urbanizmit, është dashur ta mbikqyrin dhe të shpenzohet së paku sipas praktikave, ligjeve e procedurave të qarta. Ne jemi dëshmitarë, të asaj që buxheti i vitit 2020 pjesa dërrmuese mbi 50% e projekteve kapitale të parapara për këtë vit, janë shtyrë dhe janë futur në buxhetin e vitit 2021. Për mua si asambleist dhe si qytetar ngrit dyshime, gjithashtu të bazuara, që ka pasur devijime të shumta, të qëllimshme nga Drejtoria e Urbanizmit, me leje dhe të kryetarit Begaj, të nënkryetarit, por edhe me ndikime politike, derisa na kanë sjellë edhe imazhet e një kohe, kur kemi menduar që i kemi kaluar, që projekti të shkojë aty ku është ai i parties, dhe mos të shkojë aty ku e ka paraparë buxheti. Dhe nëse e shfletoni buxhetin e vitit 2020, mund ta vëreni dallimin mes asaj që ka investime që janë kryer në vendet që nuk kanë qenë të përcaktuara të kryhen fare, dhe nuk i ke investimet aty ku i kemi paraparë ne si kuvend. Si asambleist, nuk mund të hesht ndaj këtyre shkeljeve flagrante, që janë bërë nga Drejtoria e Urbanizmit, i cili kur ka shkuar për t'i bërë matjet paraprake nëpër lagje, e ka përdorur për të kthyer njerëz në NISMA. Dhe duke krijuar një shantazh të butë, sepse shantazhet e forta më nuk kanë mundësi për t'u bërë, që nëse ne u'a shtrojmë rrugën na keni parasysh, nëse doni ju në këtë marrveshje me hy, këto janë fakte që qytetarët janë duke i thënë.

Kemi pasur ndryshime të shumta të projekteve, të rrugëve, të kanalizimeve, në secilin projekt e shihni që pjesa dërrmuese e tyre kanë devijuar, ndriçimi është devijuar, dhe ka qenë proces i një farë bashkëpunimi në mes dhe të kryetarëve të fshatrave, të përfaqësuesëve politikë aty brenda Nisma-s me Drejtorin e Urbanizmit për t'i orientuar projektet. Rruga me një shtëpi është shtruar, dhe rruga me pesë shtëpi ku ka qenë e planifikuar nuk është shtruar. Njëjtë ka ndodhur dhe me projektet e tjera. Shqetësimi rritet me përmasa më të mëdha, për faktin që vetë Drejtori i Urbanizmit është i involvuar tashmë dhe publikisht. Dihet në shumë shkelje që kanë ndodhur me tendere, në të cilat kompanitë e zyrtarëve të NISMA-s kanë qenë çuditërisht përfitues. Certifikata, diploma qysh i ka marrë ai, Drejtorit të Urbanizmit i është gjetur jo vetëm në dokumentin, që e ka bërë publik kallzo.com, por, është gjetur dhe në dokumentet tjera me të cilat ka aplikuar kompania Themeli, e cila është pronë e ministrit, e familjarëve të ngushtë të ministrit, të cilit dikastier tash është në nivelin qendror. Shqetësimi rritet dhe më shumë, kur e kemi pasur dhe nga kolegu ynë Arlindi, që e ka ngritur si shqetësim çështjen e mënyrës se si është ndërtuar edhe salla e sportit në Astrazup. Ka shkelje të shumta, përveç atyre që janë paraqitur, prej fillimit kur tenderi ka filluar e deri te realizimi, ka pozicione të shtuara në mënyrë të fabrikuar, janë shtuar pozicion për 10 tonë çelik, armaturë, apo 10 tonë cement, dhe në anën tjetër janë realizuar vetëm gjysma e tyre. Në salla të tilla të sportit, nxmjet vendosen sipër, janë ventillatorët që fusin dhe nxjerrin ajër, dhe ne me dëshirën më të

madhe e kemi votuar futjen e këtij projekti në buxhet dhe kemi bërë dhe presion për t'u realizuar. Por tash, realizimi është problem më i madh në mënyrën se si ka ndodhur, e kush po përfiton, kush po e merr realizimin e tij, cilët zyrtar brenda Drejtorisë së Urbanizmit janë të involvuar në këto shkelje flagrante, të cilët marrin përqindje, nëse nuk marrin përqindje kompanitë e tyre po përfitojnë tendere nga komuna, me emra të kompanive të tjera ose të këtyre kompanive. Thjesht, zyrtari X i Drejtorisë së Urbanizmit, e përdor emrin e një kompanie për të marrë një tender, dhe ndonëse emri, është në emër të kompanisë së jashtme, dhe realisht ky është përfitues i saj, me qëllimin që në tenderin e ardhshëm, kur e merr kjo kompani tenderin, ai me i'a kryer punët e mbikqyrjes. Të gjitha punët që i ka marrë kompania Themeli në kryerjen e punëve në Malishevë, gjithmonë është i njëjti mbikqyrës që vjen prej Drejtorisë së Urbanizmit. Shtëpia që është në ndërtim e sipër, qendra për kategoritë e dalura nga lufta, i posedon të njëjtat shkelje për të cilat po flasim dhe kjo e bënë të pafalshme heshtjen tonë. Salla e sportit në Astrazup, shkolla fillore në Gurëbardh, qendra e banimit kolektiv social në Malishevë, qendra e kategorive të dalura nga lufta e UÇK-së pranë varrezave të dëshmorëve, janë vetëm një pjesë e projekteve në të cilat ka pasur shkelje flagrante, dhe ka pasur keqpërdorime të shumta, janë shkruar më shumë e janë punuar më pak. Në gjuhën juridike është korrupsion, keqpërdorim i detyrës zyrtare, vepër e rëndë penale, dhe nuk na ka hije si Malishevë përtej politikës në këtë rast, që emri ynë të dalë nëpër media, në mënyrën se si e keni parë dhe janë përgjigjur zyrtarët komunal përfshirë dhe nënkryetarin e komunës në rastin e shkollës në Gurbardhë. A keni dëgjuar që dhe në emër të kryetarit Begaj, janë fshehur pas emrit të Begajt që sot është duke u shëruar për mos dalë dhe të jap një komunikatë, janë fshehur pas emrave të familjarëve të tyre të prekur me Covid, për mos me dale në publikë për të dhanë raportime mbi pretendimet e medieve, apo pyetjet që mediet e caktuara, i kanë bërë për shkeljet që ata i kanë evidente. Ne, si asambleistë duhet të distancohemi nga veprime të tilla. Ne nga këtu duhet t'u themi atyre njerëzve, që nuk shkon më kështu dhe njëzëri ta thërrasim prokurorin, policinë dhe këndo që merret me këto raste, e që e ka për detyrë që të vijë dhe të hulumtojë të gjitha këto pretendime të qytetarëve. Faleminderit!

Rrahim Morina: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Raportin e Drejtorisë së Urbanizmit për punët e kryera për vitin 2020 e kemi kërkuar prej fillimit të nëntorit. Unë atëherë e kam përmend dhe po e përmendi prapë, si ka mundësi të kërkohej raport të 2020 në mes të vitit 2020. A i shikoni ju afatet ligjore kur raportohet?

Ka afat ligjor që duhet deri në mars të vitit tjetër, për t'u raportuar për këtë vit. Ata që e kanë formuar ligjin, i kanë llogaritur disa gjëra, psh: kur të mbarojë viti 2020, një drejtorie i duhet kohë për të përgatitur një raport një vjeçar, për atë ligji e ka lënë deri në muajin mars, që të kenë kohë 3 muaj ta përgatitin raportin si duhet për vitin paraprakë. Drejtorja e Urbanizmit, e as ekzekutivi nuk është duke u fshehur, dhe nuk është duke ardhur të raportojë për shkak se do për të fshehur diçka, por për shkak që nuk është

koha për të raportuar. Këtu u përmendën keqpërdorime, portale e media të ndryshme të cilat kanë bërë dokumentare. Ne e dimë që një pjesë e madhe e medieve në Kosovë, në vend që të pasqyrojnë realitete, ato konstruktojnë realitete, që nuk kanë lidhje me realitetin e vërtetë, rast konkret është dhe ky rasti me kallzo. com, që është në xhep të një subjekti politik, të Vetvëndosjes e që është pjesë e rrjetit të gazetarëve Birn që e ka qendren në mes të Beogradit, dhe qëllimi i atij dokumentari është vetëm ta konstruktojë një lloj realiteti, që të godasë një figurë publike të Nisma-s, që dikush të mendojë që zgjedhjet e ardhshme mundet me qenë kandidati Nisma-së për kryetar, dhe kjo krejt është një konstruktion për të goditur një figurë të caktuar. Të njëjtat portale, të njëjtat media qeveria Kurti i ka pas përdorë, për ta bindur opinionin publik për t'ia hequr Malishevës një prej projekteve më të rëndësishme që kishte me pasë impakt të madh në zhvillimin ekonomik në vend, që ka qenë parku i biznesit. Ka përgatitur kësi konstrukcione për ta bindur qytetarin, që janë bërë disa dallavere me prona për t'ia hequr një projekt të rëndësishëm komunës së Malishevës. Ne e dimë secila medie për kë punon, andaj mos të përpiqemi të bëjmë politikë, sepse për këtë pikë të rendit të ditës nuk kemi pasur nevojë për të humbur kohë hiç, sepse nuk është koha për të raportuar. Kur të vijë koha, unë personalisht kam për të bërë presion që me ardhë për të raportuar kryetari, ushtruesi i detyrës së kryetarit, drejtori dhe kush do që është e nevojshme. Faleminderit!

Rrahim Morina: Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Përsëritet për të gjithë kolegët asamblesë komunale! Sa i përket Drejtorisë së Urbanizmit, dihet se ka ngecje si në aspektin e implementimit të shumë projekteve, po ashtu ka ngecje për shkak se Drejtoria e Urbanizmit, sikurse edhe ekzekutivi, buxhetin e bën kuvendi komunal, kurse ata janë ekzekutues të buxhetit, pra buxhetin e mbron ligji. Sa i përket Drejtorit të Urbanizmit, prej kur është emruar drejtor, ai në një formë është 'shitur' shumë kapada. Ne këtu nuk po bëjmë politikë, por këtu po merremi me shqetësimet e qytetarëve, dhe njërin prej tyre po e citoj tash, që sapo më erdhi nga një qytetar i fshatit Bubavec. Ku thotë se shqetësimi i banorëve të fshatrave Bubavec dhe Kjevë është se kanalizimet e fshatrave Mleqan, Plloqicë janë sjellë në bunaret që kemi në livadhet e Kjevës. I gjithë uji i kanalizimeve është futur në bunaret tona dhe drejtori Ahmet Morina është i informuar. Unë mendoj që drejtori Ahmet Morina, duhet të jetë më i përgjegjshëm, sepse ai ka qenë injorant dhe ndaj qytetarëve. E di mirë, si është sjellë dhe me qytetarët e fshatit Gullobovc, ku ata vijnë në formë të dokumentuar që disa rrugë në fshatin e tyre kanë devijuar. Një pjesë e madhe e projekteve ose investimeve që ne i kemi përpiluar në buxhetet e kaluara janë devijuar, siç është rasti i fshatit të ri te pika, që një lagje e ka sjellë kërkesën sepse nuk ka pasur tjetër alternativë, dhe ne në mbledhjen e kaluar e kemi dërguar përpara. Të dashur kolegë, ne jemi dëshmitarë që në një formë, në vend që Drejtori i Urbanizmit t'i implementoj të gjitha projektet, ne po jemi të detyruar të vijmë përreth dy tre muaj për një projekt të caktuar, që ai duhet ta përfundojë me kohë, p.sh. rasti i parkut në Astrazup që e keni paraparë, rasti i parkut në Tërpez, dhe

parku në fshatin Bardh, dhe ndoshta do të shkojnë suficid për shkak, që nuk po i kryen detyrat e tij qëllimisht, vetëm që të goditet një buxhet që është votuar prej shumicës së asamblesë komunale. Unë kërkoj që Drejtori i Urbanizmit dhe gjithë drejtorët e tjerë të jenë më të përgjegjshëm në detyrat e tyre.

Rrahim Morina: Sylë Dukolli e ka fjalën.

Sylë Dukolli: Kryesues, së pari u përmend fshati im prej të cilit vij, dhe qenka ankuar një banor i këtij fshati. Jam me ankesat e bashkëvendasëve të mi, mirëpo u tha këtu se njëbanor i fshatit Bubavec që i paska bunaret në Kijevë, pra ai jeton në Bubavec e bunarin e ka në Kijevë. Dhe ato vijat e kanalizimit ende nuk janë prishur, aty janë, vetëm janë shtuar prej Mleqanit që kanë ardhur dhe janë degzuar tek ura e Kijevës. Nuk jam i kënaqur me shumë projekte që nuk janë kryer në fshat, në mesin e tyre dhe të atij banorit që të ka thënë. Kryesues, ne jemi duke debatuar për një raport që nuk e kemi. Unë nuk po e di pse po bëhet debat, dhe në anën tjetër, e di që çdo projekt është i shpallur nga zyra e informimit për secilën rrugë publike e cila ka qenë në projekt, a është shpallur, a është kryer apo është në përfundim. Unë nuk e di se në cilin fshat ka mbetur ndonjë rrugë publike e cila nuk është përfunduar, në anën tjetër si dhe qysh janë kryer të gjitha kanë pasur pranim teknik, dhe nëse ka dikush që akuzon dikë, ata pranuesit teknikë, le të dalin para përgjegjësit, le ta shohin si ka qenë projekti, si është pranuar, sa material ka hyrë aty. Unë nuk parashikoj sa material ka hyrë këtu pasi është ndërtuar. Në fazat e ndërtimit bëhet prerja ku komisionet e pranimit ose komisionet përcjellëse të punës së një projekti, i cili është në ndërtim duhet t'i kenë pasur disa premje, i ka pllakat, i ka shtyllat, aty menjëherë duhet të reflektojnë, e jo pasi t'i vendosen tjegullat, të thonë se armaturë kemi futur pak. Nuk jam për ta mbrojtur asnjë, mirëpo kush ka fakte, ja ku është gjykata. Parat tona, qytetarët tanë që po i japin taksat duhet të kthehen në projekte, kjo është punë, mos u lidhni për emër i cili për momentin është Drejtor i Urbanizmit, unë nuk flas me emra. Projektet kanë qenë të kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale. Një numër të madh të asambleistëve, i kam parë duke i prerë shiritat dhe i përgzoj, por nga ana tjetër, dikujt i ka mbetur mangu veç në fshatin tim nuk kam mundur t'i shtyj projektet përpara, që në fshatrat e tjera ka shkuar. Mos të flasim për raport që nuk po e shohim, vetëm me bërë debat që tash janë shpallë zgjedhjet, mirëpo krejt në Malishevë njihemi, kush është i mbarë e kush është i mbrapshtë. Faleminderit!

Rrahim Morina: Unë po pajtohem me Sylën, që tha meqë nuk kemi raport as unë s'jam për të debatuar për këtë çështje, më mirë është me ardhë raporti dhe me i pa gjërat se si janë kryer punët. Sylë një punë po ta them me shumë përgjegjësi, nuk mund të thirrash në atë që thotë Halil Morina edhe merre ligjin për qeverisje lokale, merre dhe statutin e komunës, qartë e thotë, drejtorët janë të obliguar në momentin kur kuvendi i obligon për interpelancë ose raport, nëse nuk e kanë përfunduar, atëherë nëse e ke 9 mujor sjellë atë. Ne i kemi thënë eja deri me datën 30 shtator, atëherë sjellë atë raport se cilat punë janë kryer, cilat

janë në realizim, dhe cilat janë duke pritur të realizohen, këtë ka mundur ta bëj Sylë. Një çështje po e them, ju të Nisma-s duhet t'i bëni presion ekzekutivit, përndryshe kjo ka për t'iu kushtuar, por sido që të jetë kjo është çështje e juaja, dhe nuk kam qejf as t'ju përzihem në këto çështje. Kam thënë çdo herë që i bënë mirë pushtetit nëse ju e kritikoni ekzekutivin. Ligji për qeverisje lokale dhe statuti i komunës thotë kur do që kuvendi i kërkon janë të obliguar drejtorët të vijnë dhe të raportojnë pavarësisht në cilën fazë dhe në cilën periudhë. Ka raport 9 mujor, 6 mujor, 3 mujor, prandaj ti nuk mund të thirresh në atë që ne duhet me prit deri në mars për projektet e vitit 2020. Çështja tjetër që ka devijime të projekteve është e pakontestueshme. Në rrugën "Shpëtim Robaj" ndriçimi qëka qenëpër t'u bërë ishin 14 trupa dhe në rrugën "Ismet Robaj" që kanë qenë 3 trupa, Ahmet Morina i ka dërguar në rrugën e vetë "Abdyll Frashëri". Unë ia kisha parë për të madhe dikujt tjetër, që e dinë mirë që ka pasur devijim në projekte dhe nuk ka reaguar, po të kishte reaguar Halil Morina me thënë Ahmeti po ia ka hequr rrugën "Shpëtim Robaj" 14 drita dhe i ka dërguar në rrugën e vet, unë atëherë i them Halil mirë e ki. Aty ku e ka ndërtuar rastllën, rruga s'ka qenë dhe pse nuk ka qenë nëprojekt, rrugën nëpër ara e ka shtyer dhe e ka dërguar te stalla e vetë. Pse nuk reagon Rrahimi, e Halili, e ai tjetri, dhe aty ku nuk është e drejtë reago. Unë po e tham publikisht të gjitha projektet që janë votuar në kuvend, le të zbatohen pavarësisht kudo që janë, jo të hiqet ai dhe të futet një projekt tjetër, nuk ke të drejtë sepse është keqpërdorim i detyrës zyrtare. Faleminderit!

Rrahim Morina: Urdhëro, replikë!

Halil Morina: Kryesues, Halili asnjëherë nuk ka thënë që nuk janë devijuar projektet, janë devijuar projekte dhe jo që nuk i kam kritikuar por në raste të caktuara i kam përkrahur ato devijime, sepse kur është bërë devijimi i një projekti është bërë në bashkpunim me kryesinë e fshatit, në bashkëpunim me banorët, sepse dikujt këtu ia ka marrë mendja që i çon rrugët veç nga të dojë vetë. Nëse mendoni se një devijim i një rruge është keqpërdorim, ja ku e keni prokurorin, çone dhe thuani ky është keqpërdorim. Kjo nuk është keqpërdorim, sepse qytetarët, lagjja, kryesia e fshatit, kanë kërkuar të shtrohet një rrugë dhe ajo është shtruar.

Rrahim Morina: Halil mos manipulo, të lutem. Cila lagje i'a mundësoi me çu rrugën te stalla. Kryesia e fshatit nuk ka vendos për asnjë devijim.

Arlind Morina: Faleminderit, Kryesues! Përhëndetje anëtarë të kuvendit! Unë do të ndërlidhem me pikën që është këtu, Sylja tha që asnjë rrugë publike që nuk janë shtruar, nuk di, unë po i them Sylës që prej vitit 2018 rruga "Isuf Qerkini" në fshatin Astrazup që është futur në projekt buxhetinin e vitit 2018, pastaj me bartjen e mjeteve e kemi futur prapë nuk është kryer dhe e treta herë këtë vit, prapë e kemi votuar me bartjen e mjeteve dhe prapë nuk është kryer, është rrugë që lidhet me rrugën kryesore "Ibrahim Mazreku". E sa i përket Halilit, që tha kryesia e fshatit, unë jam pjesë e kryesisë së fshatit dhe asnjë

mbledhje nuk është thirrur për të devijuar kjo rrugë. Në lagjen Krasniqi, Bajraktar, Elshan janë ato lagje, që ne vetë me parat tona e kemi bërë ndriçimin publik, dhe drejtori i urbanizmit del thotë ky ndriçim është privat dhe nuk bën të rregullohet mirëmbajtja e tyre, në vend se t'i falënderoj ato lagje që ia kanë lehtësuar projektin, ai nuk u ndihmon për t'i rregulluar, që kanë pasur probleme me dritat.

Rrahim Morina: Hashim Vrenezi e ka fjalën.

Hashim Vrenezi: Përshëndetje për të gjithë! Unë besoj që secili prej nesh, përfaqësues të popullit këtu, duhet ta mbështesim kërkesën e raportit nga Drejtoria e Urbanizmit. Mos të kapim këtu për pjesë germash. Unë mendoj, që secila drejtori çdo fundmuaj duhet ta bëjë përmbylljen dhe rikapitullimin e punëve mujore, dhe në qoftëse kërkohet një raport prej kuvendit komunal, ai të sillet deri në muajin e fundit kur kërkohet. Nëse kërkohet ata me qenë prezent për të na dhënë sqarime për çështje konkrete, kishte qenë mirë me qenë këtu, për shkak se ne si asambleistë të partive të ndryshme po konfrotohemi mes vete duke akuzuar jo duke i mbrojtur, por nuk po zgjidhim problem as nuk po mbërrijmë te përgjigja që duhet me pas. Ne jemi dëshmitarë të menaxhimit të buxhetit të komunës sonë, ku komuna jonë qëndron për dy vite mbrapa në realizimin e projekteve, për shkak se nuk janë realizuar projektet e vitit 2018, por janë realizuar në vitin 2019, projektet e vitit 2019 po realizohen në vitin 2020. Më tregoni mua cili është ai projekt, që ka qenë në buxhetin vitit 2020 dhe është realizuar? Ne faktet nuk mundemi t'i shtrembërojmë, sepse kjo është e vërteta. Te pjesa e keq menaxhimit dhe shkeljeve ligjore, ajo është pjesë tjetër që ne sigurisht edhe u jemi adresuar organeve ligjore, ku janë në pyetje 1.000.200 € ,që ne konsiderojmë që ka shkelje ligjore në atë pjesë për shkak se kemi devijime të projekteve dhe keq raportim. Është raportuar një projekt që është i shpenzuar, por realisht projekti në teren nuk ka ndodhur. Hetuesit janë duke e bërë punën e tyre dhe besoj që e drejta një ditë duhet të triumfojë. Ju kisha lutur të gjithëve si kolegë, ta mbështesim dhe t'i japim fuqi vetës sonë këtu, për shkak se vota jonë është ajo e cila duhet ta orientojë edhe buxhetin edhe kërkesat e tona, që ne jemi përfaqësues të popullit, e jo të mundohemi t'i japim kompetencë drejtorëve individual, që ata të veprojnë sipas vullnetit dhe qejfit të tyre. Për shkak që janë drejtorë, të një drejtorie nuk kanë të drejtë të plotë për ta menaxhuar dhe për ta keqmenaxhuar në formën e tyre si të duan. Faleminderit!

Rrahim Morina: Një çështje me gjithë respektin edhe për kryetarët edhe për kryesinë e fshatrave, as kryetarët e as kryesia e fshatit nuk kanë të drejtë të devijojnë vendimet e kuvendit komunal të Malishevës. Kërkesat për projekte janë bërë para se të votohet buxheti, janë futur kërkesat e tyre, prandaj me gjithë respektin që kam për punën vullnetare që janë duke e bërë, nuk kanë të drejtë ta devijojnë asnjë projekt, dhe as të bëjnë kërkesë as kryetari e as kryesia e fshatit. Këtu janë përfaqësuesit e popullit, këtu votohet dhe këtu duhet të zbatohet ai vendim, prandaj këtu mundemi ta ndryshojmë. Nëse kanë kërkesë le t'i

drejtohen kuvendit, dhe nëse është e nevojshme ne mundemi ta ndryshojmë nëse e shohim të arsyeshme. Kjo pikë mbetet të debatohet përsëri. Unë do t'ia kërkoj materialin për janar dhe deri atëherë drejtori besoj e përgatit.

Shihemi në ora 13:00.

Rrahim Morina: Prezent janë 18. Vazhdojmë te pika 4 shqyrtimi dhe miratimi i draft rregullores për taksa, ngarkesa, dhe gjoba komunale për vitin 2021. Rregullorja iu ka nënshtruar të gjitha proceseve dhe ka ardhur për votim, është leximi i dytë. Grupet parlamentare veç i harmonizuan mendimet rreth këtyre pikave. Urdhëro, Sylë!

Sylë Dukolli: Të gjitha grupet i harmonizuan mendimet në favor të qytetarëve rreth këtyre pikave, të pagesave, dhe gjobave që janë të parapara. Nga një drejtori na erdhi dhe e përkrahëm që të shtohet përshkrimi dhe dëmtimi i rrugëve të tjera, të ndryshohet dhe gjobat të jenë 250 € për ata që i dëmtojnë,

- dëmtimi i drunjëve, i pemëve në qytet dënimi është 50 €,
- mos respektimi i orarit për mledhjen e mbeturinave nga kompania përgjegjëse gjoba është 200 €,
- hudhja e mbeturinave nga qytetarët është 50 €, ndërsa për personat përgjegjës të subjekteve afariste që veprojnë këtu dënimi është 150 €,
- në rast të mos rregullimit të dëmtimit të rrugës dhe pas pëlqimit të prerjes së asfaltit gjoba është 150 € dhe të kthehet në gjendjen e mëparshme,
- mos respektimi i subjektit afarist nga personat përgjegjës dhe pas urdhëresës nga inspektoriati gjoba 100€.
- te shërbimet postare, si taksë kanë paguar 50 €, ndërsa për shërbimet e telefonisë dhe telekomunikimit që thirret telekom kanë për të paguar 500 €,
- shërbimet e transfereve dhe pagesave më parë e kanë pasur të propozuar 70 0€ tani është 50 €.
- te Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të gjitha ato taksa që janë të vendosura nga kuvendi komunal këtu nga komuna hiqen, mbesin vetëm ato që janë të obliguara nga qendra. Këto janë të reja që u harmonizun nga grupet parlamentare. Faleminderit!

Rrahim Morina: Sylja i prezantoj ndryshimet që do të pësojë kjo rregullore.

Kush është për?

Për:19

Kundër: 0

Abstenim: 0

Konstatojmë që rregullorja për ngarkesa, tarifa dhe gjoba komunale është aprovuar. Drejtoria për Ekonomi dhe Financa pastaj merret me këto ndryshime që i përmendi Sylja.

Kalojmë në pikën e 5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1154 datë: 11.11.2020 e parashtruar nga kryetari i komunës për vazhdimin e shërbimeve të varrimit për banorët e komunës së Malishevës për vitin 2021. Urdhëro, Alban!

Alban Mazreku: Përshëndetje për të gjithë! Ne si grup e mbështesim këtë kërkesë me të njëjtin kusht, siç ka qenë vendimi i viteve të mëhershme për dy vite, çmimi për 0-5 vjeç nuk marrin shërbim, vet i kryen Bashkësia Islame. Marrveshja le të jetë dy vjeçare, çmimi 230 €.

Rrahim Morina: Kush është për?

Për: 19

Kundër: 0

Abstenim: 0

Atëherë, autorizohet kryetari i komunës që të arrijë marrëveshje në bazë të kriterëve që i ka përcaktuar kuvendi i komunës së Malishevës. Faleminderit për kontributin e juaj!

Kalojmë në pikën e 6. Rishqyrtimi i vendimit 02/473 datë: 03.12.2020, siapas kërkesës së MAPL-së nr.020-945/9 të datës: 11.12.2020 për dhënien në shfrytëzim të pronës publike KEDS-it, për vendosjen e re të stabilimenteve të nevojshme energjetike. Kanë kërkuar t'i jepet një kompenzim sepse për shkak të kompenzimit kjo është kthyer. Urdhëro, Avdi!

Avdi Morina: Faleminderit, Kryesues! Ne si grup parlamentar e kemi diskutuar dhe jemi dakorduar që të jetë një vlerë prej 5 € për meter katror, pra është për taksë vjetore .

Rrahim Morina: Alban e ke fjalën.

Alban Krasniqi: Nëparim le të jetë 5 €, mirëpo kjo nuk nënkutpon që 5 € është veç për shkak të funksionit që kanë këto lloj investimesh, si dhe pjesa që kemi insistuar në vazhdimësi që kjo nuk ia jep të drejtën ndërmarrjes që të futë as në hipotekë, as të bartet prona ndërrimi i destinimit, gjitha këto që janë jashtë kriterëve që i kemi përcaktuar.

Alban Mazreku: Këto vendime që po na i kthen MAPL-ja, realisht gjithmonë po e bënë të njëjtin gabim. Në fund të vendimit që e ka kthyer Ministria e Pushtetit Lokal këtu i drejtohet kryetarit të komunës së Prizrenit dhe jo kryetarit të komunës së Malishevës, kjo po na përsëritet gjithmonë. Mundësisht kur t'ia ktheni MAPL-së këtë ndryshim që ne po e bëjmë, për ta kritikuar që nuk e ka cekur kryetarit të komunës së Malishevës, por kryetarit të komunës së Prizrenit ju ka drejtuar.

Rrahim Morina: Ata kanë kërkuar vetëm kompenzimin për t'ia vendosur pavarësisht kuvendi çfarë vendimi merrë. Ju morët vendim për 5 € d.m.th.po i bie vjetore 45 €. Shkojmë në votim.

Kush është për?

Për: 19

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 19 vota për, asnjë kundër, dhe 1 abstenim, aprovohet rishqyrtimi i vendimit 02/473 datë:03.12.2020, siapas kërkesës së MAPL-së nr.020-945/9 të datës: 11.12.2020 për dhënien në shfrytëzim të pronës publike KEDS-it, për vendosjen e re të stabilimenteve të nevojshme energjetike.

Kalojmë në pikën e 7.Rishqyrtimi i vendimit nr.02/412 datë:03.11.2020, siapas raportit të vlerësimit të MAPL-së nr.020-839/12 datës: 27.11.2020, për caktimin e lokacionit për vendosjen e pikës së transferit, për grumbullimin, transportimin, depozitimin e mbeturinave (jo të ngurta) të cilat grumbullohen nga (K.R.M) Ekoregjioni Sh.a në Prizren, njësia në Malishevë. Ata kanë kërkuar që fjala depozitim të hiqet nga vendimi, sepse nuk ka depozitim, ka vetëm grumbullim dhe transferim. Urdhëro, Sylë!

Sylë Dukolli: Së pari Ministria e Pushtetit Lokal po na i kthen si shportat e Zveqanit këto vendimet tona. Nuk e di, a është problem te pjesa e juristëve tanë, apo është problem tek ata të cilët e kanë një shabllon, dhe nëse nuk ia përmend fjalët që i kanë si në fotografi, në draft ne refuzohemi, pra le të jetë një kritikë e drejtimit tonë në drejtim të tyre. E dyta, këtu ku është marrë vendimi ka pas për dhe kundër, ne kemi thënë që së pari duhet me qenë dëgjimi publik, që shkon kompania bashkë me komunën për të biseduar me qytetarët e Drenovcit, në këtë rast dhe në bazë të dëgjimit publik, pastaj të rregullohet çështja me ministrinë për t'ua kthyer ashtu si i kanë kërkuar ata për transfer. Vendimet e kuvedit shkojnë dhe me debat publik për vendin që është caktuar. Faleminderit!

Rrahim Morina: Urdhëro Alban!

Alban Krasniqi: Faleminderit, Kryesues! Vërejtjet që kanë ardhur nga ministria, kanë të bëjnë dhe me aspektin procedural, jo vetëm emërtim dhe natyrën e emërtimeve, qysh edhe u tha. Në aspektin procedural pika e fundit thotë për lokacionin për vendosje, ndërtim të stacionit transfer për mbeturina komunale. Komuna Malishevës paraprakisht para se të ndërtohet stacioni transfer, duhet të pajiset me lejet relevante nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, përkatësisht të pajiset me pëlqim mjedisor për lokacionin në fjalë.Nëse ky proces do të kishte shkuar më parë dhe të kishte një bashkpunim mes drejtorisë, komunës dhe ministrive përkatëse, në tri lokacione të cilat kanë qenë, atëherë do të vinin nga vetë ministria orientimet e sakta se ku do të duhej të ndërtohet ky stacion. Meqenëse i kanë shkuar prej anës tjetër, motivet i dinë ata, kam qenë një prej atyre që u kam kërkuar me ngulm që paraprakisht të saktësohen qartë procedurat kriteret, se si duhet të ndërtohet ky stacion, ku duhet të ndërtohet, cili është vendi më i përshtatshëm, e pastaj formalisht ne mundemi me dhënë ose jo pëlqim, por së paku e kemi të qartë edhe

aspektin ligjor, legjislacionin, e trajtojmë çështjen e mbrojtjes së mjedistit, e trajtojmë çështjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në debat, në publik i bindim ata qytetarë nëse mendojmë që ai vend është vendi më iduhur. Për shumë arsye që i kam përmendur edhe në kohën kur është marrë ky vendim, e që kam votuar kundër, për të njëjtat arsye dhe këto shtesë që i ka dhënë ministria, unë kërkoj që kuvendi sot mos ta votoj këtë, por në të njëjtën kohë ta nxjerr vendimin për shfuqizimin e vendimit të vetë të marrë me nguti dhe pa një analizë paraprake, por pak të prirë prej disa parametrave goxha partiak dhe interesave grupore partiake dhe jo interesin publik, jo interesin e ndërmarrjes. Vendi ku e keni caktuar përveç problemeve të tjera që ekzistojnë, aty rritet një lloj i bimës që është i veçantë në tërë ballkanin. As si distancë nuk është marrë parasysh, dikun 15 km është më së paku diferenca prej vendodhjes ku e kemi diskutuar me vendodhjen këtu, është për së paku 12 km më larg prej vendit aktual ku është. Ideja ka qenë të afrohem më afër jo të largohemi dhe më tej stacionit për t'ia rritur shpenzimet, sepse keni thënë se kompania po shpenzon, ne realisht vetëm jemi duke ia rritur shpenzimet. Bazuar në këto që i thashë dhe në ato që i kam thënë dhe më herët, kur e kam argumentuar që pse nuk duhet të zgjidhet ky lokacion. Unë kërkoj nga ju që ta shfuqizojmë këtë vendim, dhe procesi të fillojë duke u bazuar në ato që i tha dhe Sylja prej dëgjimit publik me qytetarë, trajtimin më profesional të kësaj problematike dhe përcaktimin e një vendi që e trajton anën ekonomike të kompanisë, anën mjedisore dhe aspektin social, që nënkupton vendbanimet, distanca, trafiku, rruga e gjitha këto që do të duhet të adresoheshin para se të merrej një vendim i tillë. Faleminderit!

Rrahim Morina: Sadije Krasniqi e ka fjalën.

Sadije Krasniqi: Faleminderit, Kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Diskutuan edhe para folësit, ne faktikisht e kemi marrë një vendim në parim që i hapë rrugë një diskutimi publik, mirëpo unë konsideroj që fillimisht është gabim që nuk na është dhënë informacioni i duhur, ndoshta është nguti sepse nuk është dashur pa idëgjuar të gjitha këto diskutime ta marrim këtë vendim. Drejtoria përkatëse është dashur të na informojë që e kanë vendimin mjedisor, e jo të vijnë e të na vendosin në një farë forme në lajthitje pa pëlqim mjedisor. Unë e konsideroj që kjo nuk duhet të vazhdohet më tutje, dhe kërkoj nga ju që ky vendim të shfuqizohet. Ky është mendimi im, dhe kërkoj nga të gjithë që të shfuqizohet. Ka qenë një vendim në parim, ka qenë për diskutim publik, mirëpo me këto plotësime e kemi parë që nuk duhet të vazhdojë më tutje. Duhet të analizohen gjitha vendbanimet, ku është një lokacion më i përshtatshëm dhe konsideroj që ky lokacion nuk është lokacion i përshtatshëm, dhe si i tillë kërkojë që të anulohet.

Rrahim Morina: Valon, e keni fjalën.

Valon Krasniqi: Sa i përket kësaj pike, unë me fillim e kam parë që faktikisht ka pasur mungesë të dokumentacioneve, po ashtu dhe të informacioneve për ne si asambleistë. Unë pajtohem si asambleist, jo

si grup parlamentar, sepse nuk e kemi diskutuar ende si grup parlamentar dhe jam i gatshëm për shfuqizim të këtij vendimi. Unë mendoj që pa një dëgjim publik, as qytetarët e asaj ane nuk e kanë merituar një vendim të tillë. Unë edhe herën e parë nuk kam rënë në lajthitje, po ashtu, prapë nëse ka disponim për një iniciativë për ta shfuqizuar këtë vendim, vota ime do të jetë pro.

Rrahim Morina: Urdhëro, profesoreshtë!

Hidajete Mazreku: Faleminderit, Kryesues! Përhëndetje për të gjithë! Sa i përket vendimit që e kemi marrë, ne gjithmonë kemi marrë vendime atëhok, nuk diskutojmë paraprakisht se ku e çka do të ndërtohet. Unë kam qenë kundër për atë arsye sepse nuk kanë paraqitur tri lokacione dhe u formuan grupacionet, dhe debatuan jashtë si e tek dhe erdhëm deri këtu. Unë e kam një kritikë, posaçërisht për të gjithë ne, duke e përfshirë dhe vetveten, sepse ka raste kur dhe unë votoj, mirëpo Ministria e Pushtetit Lokal nuk na ka faj neve, por ne vet kemi faj, performancën e komunës së Malishevës e vendos në fund sepse çdoherë nuk jepet performanca e mirë. Merrni komunat për rreth si Drenasi, Rahoveci të gjitha kanë marrë grande pse ne jo, ne vet jemi fajtor. Ju e dini se plani hapësinor zhvillimor është aprovuar, mirëpo sot e kësaj dite ne nuk kemi nga Urbanizmi dokumentacionin ku nuk mund të ndërtohet ajo ose kjo. Unë jam që të shkohet në dëgjim publik dhe Urbanizmi le ta gjejë lokacionin se bashku me institucionet për mbeturinat, ata i dinë ku mund të vendoset. Neve si asambleistë duhet që dokumentacioni të na sillët i gatshëm, jo ne atë ta debatojmë, jo unë dua këtu, jo unë aty. Ju faleminderit!

Rrahim Morina: Unë nuk e di çka po thuhet, ose e kemi marrë shpejt, ose e kemi marrë ngadalë, kjo çështje ka zgjatur disa muaj, dhe e kanë debatuar bukur shumë, ka pasur dallime vetëm te vendi, tash MAPL-ja ka kërkuar që të plotësohet. Hashim e keni fjalën.

Hashim Vrenezi: Tash këtu po shihet që ne po i marrim vendimet ndoshta, por po kemi qejf ta hedhim fajin ose në atë pjesë ose në këtë pjesë, por vendimi është marrë me shumicë votash dhe ne i kemi dhënë vërejtjet tona, edhe në KPF edhe në kuvend, që forma e kërkesës që ka ardhur prej qeverisjes, nuk ka ardhur në formën e duhur, ne si asamble nuk kemi faj. Unë vazhdimisht kam thënë që duhet bërë një dëgjim publik me qytetarët e asaj zone, ku të vendoset ky lokacion, nëqoftëse nuk bëhet dëgjimi publik me qytetarët e asaj zone, atje mund të kemi problem, dhe nuk mundet të funksionojë ideja e kësaj pike funksionuse atje. Ndërsa sa i përket vendimit, ka disa procedura ose të qëllimshme ose të pa qëllimshme, dhe është një problem që i përket qeverisjes që nuk kanë marrë leje mjedisore, nuk kanë marrë pëlqim mjedisor. Ne si kuvend nuk shkojmë të shtrojmë kërkesë te Ministria e Ambientit e të marrim pëlqim mjedisor, këtë dosje është dashur ta kompletojë qeverisja lokale, dhe jo të na vendosë në lajthitje me tri lokacione, dhe të tentojë të bëjë politikë, jo ky grup ose ai grup vendosin ta çojnë lokacionin atjeose këtu. Një çështje është e sigurt, ne duhemi ose s'duhemi të kemi pikë të transferit në Malishevë, në qoftëse

pajtohem që duhet të kemi një pikë të tillë, atëherë ne duhet t'ia caktojmë një lokacion diku. Nëse ne nuk pajtohem që nuk duhet të ketë pikë transferi dhe Ekoregjioni le t'i transportojë mbeturinat direkt atje, atëherë pajtohem për këtë pjesë. Unë pajtohem me këtë pjesë, por ne nuk e kemi thirrë nëpërgjithësi Ekoregjionin për të na sjellë një analizë, një raport financiar të gjendjes të tyre, dhe shpenzimet që i kanë në Malishevë, dhe ta shohim se a janë të vërteta ato që kanë kosto shumë të madhe në qoftëse e bëjnë transportin e mbeturinave direkt atje. Faji mos le të hedhet te grupet këtu, sepse ne nuk kemi faj, faji është i qeverisjes lokale që përgatitja e lëndës nuk ka ardhur në formën e kompletuar. Në qoftëse ne pajtohem se duhet të ketë pikë transferit, është mirë që mos të tentohet të thuhet ta anulojmë këtë vendim, sepse e kemi marrë ngutshëm dhe të tentohet ta hedhin fajin te një pjesë që e kanë ngritur dorën për të pasur këtë pikë. Dhe pas njëkohe, prapë do ta kemi një pikë transferi dhe prapë kemi për ta ngritur dorën për atë pikë të transferit. Kudo që të vendoset ka për ta pasur afër një lokacion të banorëve, sepse ne nuk mundemi ta dërgojmë atje ku nuk ka lokacion, sepse nuk është vendi i përshtatshëm dhe ka për të pasur distancë më të madhe të transportit. Faleminderit!

Rrahim Morina: Faleminderit, Hashim! Dhe unë po pajtohem që për këtë pikë kemi biseduar shumë, dhe nëse mendon Malisheva të ketë pikë transferit, duhet të votohet kjo dhe nëse jo atëherë e anulojmë vendimin dhe autorizohet qeverisja komunale që t'i përgatitë procedurat ligjore.

Alban Krasniqi: Në bazë të asaj që dëgjova, shfuqizimi është diçka që po shihet si rrugëdalje, por dhe në bazë të deklarimeve të antarëve të tjerë të kuvendit, unë kisha propozuar pika 1. Kuvendi të marrë vendim për shfuqizimin e vendimit të vet të datës kaq. Të autorizohet drejtoria përkatëse ose qeverisja që t'i bëjë të gjitha analizat paraprake në bashkëpunim dhe me Ekoregjionin mbi nevojën ose jo të pasurit të një pike të transferit, dhe të vijë me një raport mbi domosdoshmërinë e pikës së transferit, dhe me propozimet se ku do të duhet të vendoset ajo pikë e transferit. Mund të themi se autorizohet qeverisja lokale ose kryetari Begaj, që sipas procedurave dhe kriterëve ligjore të bashkpunojë në koordinim me nivelin qendror. T'i sjellë të gjitha dokumentet e nevojshme mbi domosdoshmërinë ose jo të pikës, në bashkëpunim dhe me Ekoregjionin dhe propozimet ku jepen, të jenë në përputhje me kriteret që i përcakton ministria dhe arsyeja për caktimin e lokacionit të bëhet në bashkëpunim me Ekoregjionin dhe kërkesa të jetë e detajuar. Sepse nëse është kostoja në pyetje, ne nuk shkojmë ta dërgojmë në Kijevë, por dihet territorialisht që do të shkojmë dhe e gjejmë një vend më të përshtatshëm. Banorët e Drenovcit tashmë janë mobilizuar dhe me petition dhe me forma të tjera ta kundërshtojnë vendosjen e kësaj pike të transferit. Faleminderit!

Rrahim Morina: Vetëm dhe një çështje dua t'ua bëj me dije, nëse doni t'i bini pishman, ju kur të doni bjerni pishman, kjo që është ardhur nga ministria thotë që nuk është në kundërshtim me ligjin vetëm kërkon që t'i hiqet fjala depozitim, ndërsa për të kërkuar pëlqim mjedisor, thotë para fillimit të ndërtimit

të ndërtesës për mbeturina. Unë e hedhi në votim ndryshimin e formulimit sipas kërkesës së MAPL-së nëse nuk kalon kjo atëherë e hedhim në votim shfuqizimin e vendimit. Janë dy propozime 1. Kërkesa e MAPL-së për për ndryshimin e riformulim të vendimit nr. 02/473 datë: 03.12.2020 të kuvendit që të hiqet fjala depozitim dhe të mbetet vetëm grumbullim dhe transferim.

Kush është për?

Për: 0

Kundër: 12

Abstenim: 8

Nuk kalon kërkesa e MAPL-së.

Kush është për shfuqizim të vendimit?

Për: 11

Kundër: 0

Abstenim: 9

Ky vendim i kuvendit anulohet dhe tash mbetet çështja e qeverisë që s'ka për të mundur kurrë që ta gjejë vendin.

Kalojmë në pikën tjetër 8. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës i Komitetit për Barazi Gjinore. Kush është për?

Për: 18

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me 18 vota për miratohet raporti i Komitetit për Barazi Gjinore.

Kalojmë te pika 9. Shqyrtimi dhe miratimi i draft planit të punës nr. 02/509 datë: 9.12.2020 i Komisionit Komunal të Aksionarëve për vitin 2021.

Kush është për?

Për: 18

Kundër: 0

Abstenim: 0

Kalojmë në pikën tjetër 10. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të veprimit për vitin 2021 i Komitetit për Familjet e Dëshmorëve.

Kush është për?

Për: 18

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me 18 vota për aprohet dhe plani i punës i Komitetit për Familjet e Dëshmorëve për vitin 2021.

Kalojmë në pikën tjetër 11. Shqyrtimi i raportit të punës për vitin 2020 i Komitetit të Arsimit, Kulturës, Rinis dhe Sportit.

Kush është për?

Për: 18

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me 18 vota për aprohet raporti i punës së Komitetit të Arsimit për vitin 2021.

Kalojmë në pikën e 12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.12/227 datë 10.12.2020 të parashtruar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për miratimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal 2021-2023.

Kush është për?

Për: 19

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me 19 vota për aprohet Plani i Veprimit Rinor Lokal 2021-2023.

Kalojmë në pikën e 13. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2021.

Kush është për?

Për: 20

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me 20 vota për aprohet Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2021.

Kalojmë në pikën e 14. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/503 datë:7.12.2020 e parashtruar nga N.T.P “ILI”, nga fshati Banjë për lirim nga pagesa e kështit të katërt të shfrytëzimit të pishinës publike në fshatin Banjë. Hapim debat rreth kësaj çështje. Nëse nuk e don askush fjalën, shkojmë në votim.

Kush është për?

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim: 3

Me 17 vota për, asnjë kundër, dhe 3 abstenime i falet kështi i katërt N.T.P “ILI” nga fshati Banjë.

Para se të kalojmë te kërkesat e shtëpive, e kemi futur kërkesën e Alban Krasniqi, shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/529 datë 18.12.2020, e parashtruar nga Alban Krasniqi anëtar i Kuvendit Komunal, nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, lidhur me marrjen e vendimit për ndarjen e pakos financiare për bizneset e vogla të prekura nga masat restriktive dhe kriza e shkaktuar nga pandemia Covid-19. Urdhëro, Alban!

Alban Krasniqi: Faleminderit, Kryesues! Ju e keni përpara kërkesën, është shumë e detajuar dhe besoj që nuk lë hapësirë për keqkuptim. Ideja e kërkesës është që të ndihmohen bizneset. Janë dy mënyra se si mund t'i ndihmojmë. E para: bizneset që kanë përfutur prej nivelit qendror, nuk i bie që mund të përfitojnë tani, mirëpo kjo i dedikohet kryesisht bizneseve të vogla, por që bien në kritere të cilat ne së bashku do t'i përcaktojmë. Kjo do të bëhet përmes një komisioni që e ngrisim duke i parë dhe shembujt dhe dobësitë që i kemi parë nëpër komunat tjera të cilat i kanë ndihmuar bizneset, në mënyrë që me target të arrijmë tërësinë e biznesit që ka nevojë. Sipas kritereve dhe standardeve aq sa mund të definohen, duke përfshirë dhe shumat, kategorizimin e shumave, numrin e të punësuarve, nivelin se sa ka mundur të preket ai biznes, duke përfshirë dhe fazat, siç e dini 3 faza kanë qenë deri më tani që qeveria ka ndërmarrë për masat restriksionet.

Komisioni i nxjerr kriteret, dhe pastaj bëhet shpallja, dhe pas shpalljes nënkryetari përcakton komision tjetër që merret me mbarrëvajtjen e atij procesi. Sepse ne i përcaktojmë vetëm kriteret, dhe ky komision ta kryej të njëjtën punë, pra i njëjti komision të kryej një punë tjetër, atë që i kujtohet edhe Hashimit që kemi biseduar, sepse e ka ngritur dhe ai çështjen e faljeve të borgjeve të vjetra. Besoj që ka ardhur koha që ky komision të marrë dhe këtë detyrë shtesë ta shoh anën ligjore, bashkë dhe me ekzekutivin, bazën, kriterin, standardet, e procedurat në bazë të cilave ne i bëjmë, shpalljen, aplikimin, selektimin për t'ua falur borgjet e obligimet ndaj komunës, që i kanë bizneset e caktuara, të cilat disa janë shuar, disa janë në krizë ende dhe nuk ka shanse që ta paguajnë atë shumë të mjeteve. Kur flas për bizneset e vogla, keni parasysh që bizneset e vogla janë dhe ato rrobaqepësitë, frizerët, sallat e dasmave, fushat e futbollit dhe besoj që ky komision i definon të gjitha. Propozimi është, komisionit nuk është mirë t'i lihet ta ndaj nivelin e shumës që e dajmë, sepse nuk është detyrë e komisionit, por ne mundemi në parim ta themi këtë shumë ose atë shumë në dakordim dhe tuajin. Është vetëm si propozim, sipas një planifikimi të caktuar, sepse shumë 200.000 euro mund ta marrë prej 5% të kapitaleve, por mund ta marrë dhe prej formave të tjera brenda shtesave që mbesin, e kam fjalën për buxhetin e vitit 2021, 2020 nuk e di sa kemi hapësirë, sepse drejtori nuk është për të treguar se a mundemi ta ndajmë ndonjë mjet që ta dedikojmë për këtë punë.

Rrahim Morina: Drejtor a mund të na informosh, se a ka mundësi buxhetore këtë vit për t'i ndihmuar bizneset e vogla për shkak të pandemisë. Domethënë këtë vit nuk ka mjete, mbetet për vitin e ardhshëm. Unë jam pro që të jetë një komision ipërbashkët ekzekutiv dhe kuvend. Urdhëro, Hashim!

Hashim Vrenezi: Po më duhet t'i ceku disa çështje. Nëse ju kujtohet kur kam bërë kërkesë të falen bizneset dhe të kërkohet një formë se si mund ta falim një pjesë të borgjeve. Kjo pjesë e faljes së borgjeve, kam kërkuar me qenë e asaj forme që ata t'i shtyjë dhe t'omotivojë qëtë paguajnë pjesën tjetër, dhe për të krijuar të hyra për vitin 2020, për shkak se ne i liruam prej taksave dhe këtu të gjitha zyrtat në kuvend kanë qenë kundër. Sikur të ndërmerrnim masa në kohën kur kam kërkuar unë për ta bërë këtë punë, tash kjo temë ishte e mbyllur. Tash na vjen një propozim prej Lëvizjes Vetëvendosje që ta formojmë një lloj të pakos për mbështetje të bizneseve, unë nuk jam kundër mbështetjes së bizneseve, unë jam pro harmonizimeve, qëndrimeve të ndarjes dhe të ndihmës së bizneseve që janë të dëmtuara nga pandemia. Ne jemi dëshmitarë që qeveria e Kosovës i ka pasur disa pako për rimëkëmbje ekonomike dhe për t'i suvencionuar bizneset në forma të ndryshme. Ligji i fundit që është i përkrahur dhe është fuqizuar me meritën e PDK-së akoma nuk është zbatuar plotësisht. Pako për rimëkëmbjen ekonomike ka ngecur, dhe falë PDK-së është futur në funksion dhe sot e kemi gëzuar shumica e përfituesve të trustit që u kanë dalur në kontot e tyre në këto festat e fundvitit. Mos të bëhemi prej atyre që duhet të bëjmë politikë dhe të tentojmë t'i marrim meritat në format kur neve na konvenon, ose temat kur i ngritë dikush, dikush tjetër t'i kundërshtoj në atë kohë dhe mbas disa mujve të kthehet dhe t'i fuqizoj ato tema. Megjithatë ne jemi dëshmitarë që edhe kryetari i komunës e ka formuar një komision, i cili ka pasur për qëllim të bëjë një vlerësim të bizneseve se sa janë të dëmtuara për shkak të pandemisë Covid-19, dhe ai komision nuk na ka raportuar asnjëherë. Unë mendoj që ai komision duhet ta sjellë një raport, sepse nuk e di cili ka qenë funksioni i atij komisioni është formuar, a ka qenë vetëm për t'i marrë disa meditje ata, a ka qenë për të kryer ndonjë punë të duhur që duhet të kryhet. Punës së atij komisioni duhet t'i paraprijë edhe një informacion nga drejtori i financave, se si do t'i ndajmë këto 200.000€ që ika propozuar nga investimet kapitale. Ne duhet të sigurohemi që administrate lokale, këtu e ka kapacitetin të bëjë një organizim të punës së tillë, dhe të na përkrahë sistemi i teknologjisë, që forma e publikimit të kryhet online për këto kërkesa dhe të mos ketë diferencime të bizneseve mbi baza të ndryshme partiake ose klanore. Faleminderit!

Rrahim Morina: Avdi Morina e ka fjalën.

Avdi Morina : Faleminderit, Kryesues! Sa i përket kësaj pike të nderuar, mendoj që jemi në fund të vitit dhe është shumë problematike që të parashohim një pako të tillë, meqenëse dhe ligji për rimëkëmbje ekonomike paraqet mbështetjen e bizneseve të caktuara. Unë mendoj që kishte me qenë më mirë që të shtyhet për mbledhjen e radhës, dhe të shohim të gjitha ato biznese që nuk marrin përkrahje nga pakoja për rimëkëmbje ekonomike, dhe t'i trajtojmë dhe t'i mbështesim në bazë të një analize që do të kishte dalur nga një komision. Mendoj që duhet të shtyhet dhe të trajtohet e analizohet më mirë kjo pikë e rendit të ditës. Faleminderit!

Hidajete Mazreku: Faleminderit, Avdi! Alban Krasniqi e ka fjalën.

Alban Krasniqi: Mund të thoni çka të doni e si të doni. Këtu është vendi, këtu është koha me qenë pro bizneseve dhe kundër bizneseve. Dikush po thotë që kemi qenë gjithë kundër, mirëpo ekzistojnë regjistrime dhe procesverbale, dhe nëse e gjenë një kundërshtim për çështjen e faljeve të borgjeve, përveç që kemi kërkuar raportin prej drejtorisë së financave, mirëpo nuk na e kanë sjellë. Për sa i përket komisionit për menaxhimin e Covid -19, nuk është në natyrën e komisionit Covid-19 të merret dhe me këtë punë, por nëse doni të na jepni dhe atë atribut nuk është problem, e marrim nëse nuk keni guxim të bëni një komision tjetër. Propozimi është i qartë unë e kam shkruar, por nuk është propozim veç i imi sepse është dhe i juaji, sepse e kemi diskutuar. Avdiu tha e shtyjme se kriteret, Avdi nëse e lexon kërkesën e ke shumë të qartë, kërkesa thotë 'formohet komisioni që merret me ato çështjet' që t'i po thua në parim bizneset i dinë që neso ose pasneser kanë për t'u mbështetur, sipas disa kriterëve që ai komision ka për t'i përcaktuar. Mos harroni bizneset që kanë fituar nëpër komunat tjera, ka dhe biznese që kanë përfutur dhe prej nivelit qendror, por për çfarë kategorie, këto janë po të njëjtat kriterë dhe duke shtuar kriterë tjera, mundemi t'i përdorim, dhe e kemi më lehtë. Sepse tash veç janë dhënë pako financiare emergjente prej komunave të ndryshme për bizneset, e kemi më lehtë për t'i marrë dhe mos ta bëjmë gabimin e njëjtë si ka mundur ta bëjë komuna e Prishtinës, që e ka pasur një trajtim shumë teknik dhe nuk ka shikuar në përmbajtje, dhe pastaj ka dalë pak i devijuar procesi. Sapo i dhamë 10.000 euro për një biznes dhe tash duam të jemi kaq dorështrëngues dhe të kërkojmë çdo detaj për bizneset tjera, nuk po me duket në rregull, ta mbajmë atëherë standardin e njëjtë. Asnjë dokument nuk e di unë të xhirollogarisë të biznesit në fjalë që ka pasur fitim ose s'ka pasur fitim. Ne e dimë që ka qenë një fazë që kanë mundur të punojnë dhe ky biznes, unë kam qenë pro ndihmës dhe këtij biznesi, mirëpo te qiraja është pak më ndryshe. E tash çka t'i bëjmë një fushe të futbollit që dhe ai e ka me qira, atë nuk po e trajtojmë veç që qiranë e ka te privati, e ky që ka qiranë te publiku dorëshlirë po bëhemi. Në parim marrim vendim për t'i ndihmuar bizneset, e caktojmë komisionin, nëse po ju doket herët të caktohet vlera, atëherë vlerën e lëmë përmë vonë. Vlera është vetëm për drejtorinë e financave ta ketë një orientim, se si ta bëjë rezervimin e mjeteve. Ne e dimë që 5% mund t'i marrë kuvendi prej investimeve kapitale, dhe mjete të tjera nëse nuk plotësohen ose mund t'i marrim vetëm prej 5% prej investimeve kapitale aq sa del vlera aq e kemi mundësinë. Të ecim përpara dhe t'u ndihmojmë bizneseve. Faleminderit!

Rrahim Morina: Valoni e ka fjalën.

Valon Krasniqi: Të dashur kolegë para neve ka ardhur një kërkesë nga kolegu ynë, ku kemi të bëjmë me taksat qytetare. Kushdo që është pro bizneseve që t'u kthehen taksat qytetarëve, nëse e shohim të arsyeshme, le të votojë pro dhe kushdo që është për të mos u ndihmuar bizneseve le të votojë kundër. Nuk

kemi nevojë më shumë për ta diskutuar për shkak se ato janë taksa të qytetarëve, dhe është mirë që taksat e qytetarëve të çohen te qytetarët. Faleminderit!

Rrahim Morina: Të nderuar anëtarë të kuvendit, edhe unë jam për t'i ndihmuar bizneset, por ndoshta është mirë të bëhet një analizë pak më e mirë. Kërkohej që të merret dhe një gjendje nga ekzekutivi, për shkak se disa biznese janë në gjendje të rëndë dhe pak t'u lehtësohet veprimtaria e tyre. Te falja e borgjeve ka njerëz që kanë pompa menzine, markete të mëdha dhe nuk i kanë paguar taksat komunale. Unë pajtohem me Hashimin që duhet të gjendet një motor që ifut në lëvizje p.sh. që thotë paguje 50% të borgjeve, dhe borgjet të falen, ose të gjendet një mënyrë që të nxirret diçka prej atyre njerëzve. Sepse ka njerëz që i kanë të gjitha të mirat, dhe nuk i ka paguar taksat, dhe dora ime nuk mundet t'ia falë atij. Por, duhet të gjejmë një mënyrë se si t'i fus dhe ata mekanizma, dhe të marrë diçka prej tyre. Në parim isha për ta formuar një komision, por pastaj për shuma bisedojmë me një takim tjetër. Faleminderit!

Sylë Dukolli: Qëllimi është i mirë dhe ne jemi pro formimit të një komisioni, por mos të caktohet shuma. Mirëpo, komisionet ta kenë parasysh çka do të bëhet me atë kategori të bizneseve të cilët kanë qenë të rregullt në pagesa, dhe si mundemi t'i shpërblejmë ata, ndërsa mos të bëhemi krah me ata që nuk i kanë kryer detyrimet e shtetit dhe kanë ushtruar veprimtari. Unë jam për themelimin e komisionit, të bëjnë një analizë, të vijnë këtu t'ia dërgojmë ekzekutivit dhe faktikisht ecim përpara. Viti qëpo vjen ka për të qenë viti ekzekutues, edhe i mjeteve që i parasheh kuvendi, për t'i ndihmuar bizneset që vërtetë e meritojnë, dhe që nuk bëjmë shkelje. Edhe në atë pjesën tjetër që vërtetë i kanë kryer obligimet me kohë, për arsye që nëse është biznesi shumë i trashë dhe nuk ka kryer detyrimet, ne e shohim që është biznes i pa rregullt dhe nuk bëhet asgjë, atij t'i thuhet që duhet t'i japëshmjetet sepse kapitali ekziston dhe vullneti nuk ekziston, dhe ai duhet të detyrohet. Faleminderit!

Rrahim Morina: Hashim Vrenezi e ka fjalën.

Hashim Vrenezi: Sigurisht dhe PDK-ja i mbështetë bizneset e komunës sonë, mirëpo nuk po e shohë me ngut formimin e komisionit, për shkak se për momentin nuk është që kemi diçka në dorë, që mundemi ta analizojmë dhe të krijojmë asnjë lloj qëndrimi ose asnjë lloj kriteri. Për mua personalisht, është dashur paraprakisht kësaj çështjeje duhet t'i paraprijnë disa raporte. Formimi i komisionit mund të bëhet edhe sot, por dhe nëse nuk bëhet nuk është ndonjë problem, sepse edhe nëse bëhet sot ne nuk kemi për ta filluar punën sot. Nëse nuk e kemi një raport, ku i dimë kategoritë e bizneseve për komunën e Malishevës, numrin e bizneseve që kryejnë veprimtari biznesore në Malishevë. Nëse nuk e kemi një raport të llogarive të argëtueshme që i pret komuna jonë për vitet paraprake me listë për secilin biznes, nëse nuk i kemi këto dy informata, e kemi problem edhe të ndërtojmë kritere për këto tema. Unë mendoj që në këtë pikë edhe raporti i komitetit ose i atij grupi që e ka formuar kryetari për këtë çështje, ndoshta ata mundën të na

ndihmojnë me ndonjë ide, për shkak se po supozoj se dhe ata e kanë kryer një punë. Edhe nëse nuk kanë bërë asgjë, neve na ndihmon ajo që e dimë që ata nuk kanë bërë asgjë, dhe ne fokusohemi në këto dy pjesë. Paraprakisht na duhet informacioni sa është numri i bizneseve që veprojnë në Malishevë, sa biznese kemi dhe me sa punëtorë, ose në bazë të qarkullimit. Unë mendoj që komuna e Malishevës nuk e ka aq të lehtë t'i sjellë këto statistika, ndoshta mund të na sjellë statistika vetëm në bazë të emrit dhe numrit të puntorëve, te pjesa e llogarive të argëtueshme nëpër vitet e kaluara, në këtë pjesë besoj mund të na përkrahin, mirëpo diçka tjetër nuk mund të na përkrahin. Ne nuk mund të themi se ky biznes është i madh dhe nuk duam t'ia falim borgjin. Ne nëse nuk e ndërtojmë një kriter për të falur borgjet, nuk po e ndërtojmë veç për t' i falur ato, por duhet të ndërtojmë një kriter, që në momentin që supozojmë t'i falet 20% i borgjit, ai ose duhet të futet me një marrveshje të pagesës me këste për një periudhë të caktuar kohore, ose duhet të caktohet një prag i pagesës tjetër, ose 30% duhet të paguhet dhe 20% t'i falet, dhe 50% të mbetet borgj supozojmë. Kur t'i kemi këto informacione, besoj që pastaj mundemi të krijojmë ide të përbërjes së komisionit, dhe nga përfaqësuesit politikë, por dhe ekspertë të jashtëm. Pse të mos kemi dhe ekspertë të fushës së caktuar, nuk është e thënë që patjetër me qenë përfaqësues të një partie politike, në qoftëse nuk je ekspert i fushës së caktuar, për të dhënë kontribut. Faleminderit!

Rrahim Morina: Alban e ke fjalën.

Alban Krasniqi: Jam prej asambleistëve, që kur e bëjë një kërkesë nuk lë asgjë pa e sqaruar. Edhe më shumë se kur na vijnë dokumentet prej ekzekutivit, dhe kolegët fatkeqësisht nuk e kanë lexuar fare kërkesën, se po ta lexonine kuptojnë se për çfarë komisioni kemi diskutuar, dhe e kuptojnë se statistikat prej agjencisë së statistikave të Kosovës thonë se 88% të bizneseve në Malishevë janë individuale, 99% të bizneseve në komunën e Malishevës, janë prej 1 deri në 9 punëtorë, dhe se falja e borgjeve nuk i dedikohet vetëm bizneseve të vogla, por edhe atyre që janë të mëdha. Këtu thuhet që puna e komisionit është e përshkruar në detaje te pika tre e kërkesës. Kuvendi komunal formon një komision të përbërë nga kuvendi dhe ekzekutivi me mandat të përkohshëm, dhe i keni detyrat që mund të plotësohen dhe mund t; hiqen. Nuk është detyrë e komisionit të bëjë analiza, sepse analizënuk është bërë për bazenin e Bajës, nuk është bërë analizë për klubin e sportit. Shumë mirë që i'a kemi dhënë 50.000 euro klubit të sportit, është ¼ e kësaj ndihme që unë e kam propozuar. ¼ i'a kemi dhënë një klubi të futbollit, dhe 500 bizneseve minimum, po shikoni t'i ikni përgjegjësisë si asambleistë. Ky komision i ka detyrat e qarta, duhet t'i vendos kriteret në bazë të cilave krijohet ai proces, dhe realizohet procesi i aplikimit të përzgjedhjes. Atë proces e bën ekzekutivi e nuk e bëjmë. Tashmë që po e shohë që ka tendecë për ta degraduar kërkesën, unë isha i hapur për ta pasuruar me çka do, por jo, tash të themi jo se qesim shumë. Shikoni me më shumë seriozitet, sepse është dhe kërkesë e bizneseve të shumta, 10.000 euro sapo i'a falët një biznesi,

dhe po bëheni kaq të kujdesshëm për t'ia falur një rrobaqepëses. Unë nuk mund të përdorstandarde të dyfishta brenda gjysmë ore. Faleminderit!

Rrahim Morina: Alban Mazreku, e ka fjalën.

Alban Mazreku: Përshëndetje për të gjithë! Në shtëpinë e kulturës ka lindur ideja e faljes së borgjeve të bizneseve që i kanë komunës së Malishevës. Mirëpo, gjithmonë me një marrveshje paraprake. Kërkues ke qenëedhe ti, Hashimi, Avdia dhe unë njëri prej atyre që e kam propozuar. Mirëpo, gjithmonë duke e pasur një marrëveshje bashkëpunimi me bizneset në fjalë, dhe t'u falen borgjet. Unë prapë po e përkrahuatë sqarimin tuaj, për pikën 3 dhe 4 që të krijohen komisionet, shumë nuk po ndajmë sot, dhe këtu gjithë janë për t'i ndihmuar bizneset, mirëpo të ketë një raport paraprak. Propozimi im në kuadër të këtij vendimi për krijimin e këtyre dy komisioneve, dhe duke i bërë thirrje qeverisjes komunale për t'i ndihmuar bizneset. Të futet si pikë e vendimit dhe të obligohet qeverisja komunale, që në mbledhjen e janarit t'i sjellë të gjitha raportet, ashtu siç i ceku Hashimi për bizneset që operojnë në komunën e Malishevës. Për t'i ndihmuar dikujt qëna ka borgj, pa ndonjë marrëveshje paraprake, kjo nuk është nërregull. Në kuadër të vendimit të futet dhe kjo, të obligohet qeverisja komunale, në këtë rast Drejtoria e Financave në bashkpunim me zyret e bizneseve, këto le tëna sjellin neve si pikë të 5.

Rrahim Morina: Drejtor, e keni fjalën.

Valon Mazreku: Përshëndetje për të gjithë! Ideja për t'i falur borgjet të cilat janë akumuluar ndër vite, dhe për të cilat nuk kemi pasur mundësi për t'i inkasuar, e që ndër vite ka qenë dhe si rekomandim i Zyrës Kombëtare të Auditimit, dhe të cilët janë hapa që i ka marrë komuna për t'i falur këto borgje ose për t'i inkasuar këto mjete, kanë hasur në vështirësi. Sa kam informacionka anëtarë të kuvendit, që kanë qenë dhe në legjislatura të tjera, ku ka pasur tendencë dhe në legjislacionin tjetër, për të ndodhë diçka e tillë, mirëpo nuk kanë mundur, nuk e di për çfarë arsye. E para është falja e borgjeve që e ngritë nivelin e inkasimit, mirëpo te përcaktimi tek ajo se cilat lista, numri i punëtorëve, kur bëhet regjistrimi i bizneseve në zyrën komunale, ka disa biznese për të cilat kërkohet përcaktimi fillestar i numrit të punëtorëve. Mirëpo, ka disa forma të organizimit të bizneseve për të cilat nuk kërkohet përcaktim fillestar i numrit të punëtorëve. Unë konsideroj që në bashkëpunim me Administratën Tatimore, besoj që Administrata Tatimore e ka vullnetin për të bashkëpunuar në këtë raport, dhe numrin e punëtorëve e marrim në kuadër të Administratës Tatimore. Numri i bizneseve kanë qenë publike. Bizneset janë aktive, dhe ato janë publike, dhe ka shumë biznese që janë pasive. Ne e sjellim listen e uliguesve që janë për taksën e ushtrimit të veprimtarisë. Cilat janë ato biznese që sot ose për shumë vite me radhë nuk kanë qenë aktive, ose nuk e kanë ushtruar aktivitetin e tyre. Mirëpo për shkak se të njëjtat, nuk e kanë regjistrimin formal të dokumentuar, në kuadër të zyrës ARKP-së, atyre vetëm iu është ngarkuar taksa. Sa herë që kuvendi

komunal ka marrë vendim që për t'i ngarkuar bizneset me taksa, pavarësisht çfarido qoftë vlere, dhe ai faktikisht nuk e ka ushtruar aktivitetin, por juridikisht atij i ka ecuar aktiviteti, për shkak se ai formalisht nuk është marrë me mbylljen e biznesit. Sa i përket të argëtueshmeve, nga kjo kategori e të hyrave ne e sjellim borgjin, unë kam tentuar ta sjellë borgjin, mirëpo tek evidencat të cilat janë mbajtur ndër vite është një komplikim, sepse në disa evidenca nuk janë pasqyruar borgjet e bizneseve të cilat e kanë shuar aktivitetin e tyre në mënyrë formale. Logjikisht kemi një borgj më të madh, kurse të paraqitur kemi një borgj më të vogël, dhe këtu kërkohet të bëhet një analizë për t'i identifikuar të gjitha ato, për të deklaruar se cili është borgji i saj. Unë konsideroj që nuk mundta bëjmë për një muaj, dhe konsideroj që ndihma ndaj bizneseve është e domosdoshme, dhe e nevojshme, mirëpo nëse e kushtëzojmë ndihmën e bizneseve me faljen e borgjeve, ose pse ata janë obligues ndaj komunës. Unë konsideroj që është qasje e gabuar, sepse ne nuk mund të themi që biznesit X po ia ndajmë 1000 € sepse nuk ka obligime ndaj komunës, ndërsa biznesit Y po ia falim 1000 €, sepse ka pasur obligime ndaj komunës. Ne kështu po krijojmë një pabarazi kundrejt atij biznesi që ka qenë i përgjegjshëm, në raport me biznesin që nuk ka qenë i përgjegjshëm. Unë besoj që ne kemi për ta gjetur, zgjidhjen më të mirë, për t'iu dalë në ndihmë këtyre. Kërkoj që në komision me qenë edhe prej Drejtorisë së Financave, për shkak të detyrave që i kemi. Faleminderit!

Rrahim Morina: Urdhëro, Hashim!

Hashim Vrenezi: Bizneset të cilat nuk janë aktive, Valoni e dimirë, që çdo biznes që është aktiv çdo muaj bënë deklaratimet në administratën tatimore, nëse ka punëtorë, në qoftëse nuk ka punëtorë, ose është në tvsh ose nëse nuk është në tvsh, të paktën në tre muaj pa bërë një raportim në administratë është e pamundur. Si kriter mund ta bëjmë, në qoftëse biznesi nuk ka bërë raportime në administratë, ose ka bërë deklaratimet me 0 në periudhën e fundit p.sh. në këto 3 vitet e fundit. Për këto 3 vite të shkarkohet nga taksa që është ngarkuar nga Komuna, për taksat komunale, për shkak se 3 vitet e fundit, ai ka deklaruar që aktiviteti tij ka qenë pasiv. Është e thjeshtë për ta manaxhuar këtë punë, por nuk është punë që kryhet shpejt, mirëpo neve së pari na duhet lista e bizneseve, raportet që i kërkova për t'i ndërtuar kriteret.

Rrahim Morina: Pikat i keni para vetes, vetëm po i shtohet pika nr. 5 Obligohet qeveria komunale që për mbledhjen e janarit t'i sjellë të gjitha të dhënat për bizneset, duke filluar nga lista e borgjeve dhe të tjerat që janë me radhë aty.

Pika 2 është rifomulim, domethënë pakoja, shuma caktohet nga komisioni për mbledhjen tjetër, obligohet që në mbledhjen tjetër të na sjellin shumën, se sa do të jetë për bizneset. Komisioni e merr këtë çështje përsipër.

Kush është për?

Për: 21

Kundër: 0

Abstenim: 0

Komisioni përbëhet prej 7 anëtarëve, 5 përfaqësues nga subjektet politike, drejtori për ekonomi dhe financa dhe një përfaqësues nga zyra e kryetarit:

Halil Morina-anëtar nga radhët e Nisma Socialdemokrate;

Hashim Vrenezi-anëtar nga radhët e PDK-së;

Valon Krasniqi-anëtar nga radhët e LDK-së;

Alban Krasniqi-anëtar nga radhët e VV-së;

Kastriot Berisha-anëtar nga AAK –së;

Valon Mazreku-Drejtor për Ekonomi dhe Financa,

dhe një përfaqësues nga zyra e kryetarit të komunës.

Kush është për formimin e komisionit i cili do të merret me procesin e ndarjes së pakos financiare për bizneset e vogla të prekura nga Covid-19, si dhe faljes së borgjeve të bizneseve që operojnë në komunën e Malishevës?

Për: 21

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me 21 vota për, miratohet vendimi për formimin e komisionit, i cili do të merret me procesin e ndarjes së pakos financiare për bizneset e vogla të prekura nga Covid-19, si dhe faljes së borgjeve të bizneseve që operojnë në komunën e Malishevës.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave të qytetarëve të komunës së Malishevës për merimetim dhe renovim të shtëpive.

Alban Mazreku: Për pikën që e lexoi kryesuesi, sa i përket ndihmës për shtëpi të djegura dhe atyre që kanë nevojë, propozimi ose koordinimi i të gjitha grupeve ishte që të krijohet një komision për vlerësimin e dëmeve, ku përfaqësues do të jenë gjitha subjektet politike, një përfaqësues nga zyra e urbanizmit, një përfaqësues nga zyra e drejtorisë së ekonomisë, dhe një nga emërgjencat.

Rrahim Morina: A pajtoheni që komisioni të formohet në këtë formë, 5 anëtarë të subjekteve politike, 1 anëtar nga drejtoria për urbanizëm dhe një anëtar nga drejtoria për shërbime publike.

Kush është për?

Për: 21

Kundër: 0

Abstenim: 0

Shkojmë me emra të anëtarëve të komisionit:

1. Avdi Morina-anëtar nga radhët e Nisma Socialdemokrate;
2. Hamza Bytyqi-anëtar nga radhët e PDK-së;
3. Arlind Morina-anëtar nga radhët e LDK-së;
4. Hidajete Mazreku-anëtar nga radhët e VV-së;
5. Luan Kryziu- anëtar nga radhët e AAK-së;
6. Një anëtar nga Drejtoria për Urbanizëm;
7. Një anëtar nga Drejtoria për Shërbime Publike.

Kush është për këtë përbërje të anëtarëve të komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe vlerësimin e dëmëve, për merimetim dhe renovim të shtëpive? Për:20Kundër:0 Abstenim:0

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të grupit të grave asambleiste.
Urdhëro, profesoreshë!

Hidajete Mazreku: Grupi i grave asambleiste është formuar më herët dhe si përfaqësuese jam unë. Dhe çdoherë në emër të tyre kam dalë të debatoj për çdo gjë që ka qenë në pyetje për barazi gjinore dhe dhuna në familje. Gjatë seancave që kemi mbajtur nga grupi i asambleisteve gra, kemi përcjellë në tërësi kuvendin komunal të Malishevës, dhe duke parë që kuota gjinore nuk është zbatuar nëpër komisionet dhe komitetet obligative dhe jo obligative, si dhe stërzgjatja e seancave në proces që kishim, kemi ardhur në përfundim me këto rekomandime: të zbatohet në përpikmëri rregullorja e kuvendit, të ndalohet fjalori ofendues të secili asambleist të cilitdo subjekt, të rregullohen me ligj të gjitha komitetet obligative dhe jo obligative dhe kërkesat e qytetarëve që vijnë nga zyra e kryetarit, mos të jenë në fund sepse kemi pasur shumë ankesa nga qytetarët, por të jenë në fillim ose në mes të rendit të ditës, dhe të shqyrtohen kërkesat e tyre.

Alban Krasniqi: Unë e kam një vërejtje për grupin e grave asambleiste, sepse e kanë sjellur kërkesën shumë të zbehtë. Kam pritur me qenë më përmbajtësore, më e fuqishme, më përfaqësuese. Unë e di që e keni nisur prej vullnetit të mirë, nuk po dyshoj që jeni nisur prej iniciativave të caktuara, por kam pritur më shumë që ta përkrahu me gjithë zemër. Këtyre rekomandimeve i kam bashkangjitur me numër 5 dhe një kërkesë tjetër, si dhe një plotësim për kërkesën numër 4. Jo të gjitha kërkesat vijnë nga zyra e kryetarit, disa kërkesa vijnë nga KPF-ja, pra është dashur që te rekomandimi i 4 të inkuadrohet edhe kjo pjesa, kur vijnë dhe nga zyra e kryetarit dhe nga KPF-ja, për të qenë e plotë, shtohet dhe kërkesat e KPF-së. Ky është propozimi im numër 5. Të raportohet në mënyrë periodike çdo tre muaj, për masat dhe

veprimet e institucioneve lokale në adresimin e tyre ndaj barazisë gjinore dhe dhunës në familje ose dhunës ndaj gruas. Ne e dimë që ky kuvend deri në qeshor ka mandate, dhe është dashur të dëgjojmë dy herë raportim, qoftë të kryetarit, qoftë të zyrës për barazi gjinore, që e merr stapetën e raportimit. Dhe ajo shërben që shefi t'i mbledhë të gjitha këto informacione, cilat janë masat që janë ndërmarrë prej institucioneve lokale, që i përgjigjen kuvendit në adresimin e barazisë gjinore dhe dhunës në familje, dhunës ndaj gruas në veçanti.

Rrahim Morina: Rekomandimet i lexoi profesoresha, dhe mbeti një pjesë për t'u shtuar nga kuvendi dhe trupat e saj. Te pika e 4 të përfshihen gjitha komisionet dhe komitetet, dhe në pikën 5 të raportohet çdo tre muaj nga kryetari dhe zyra për barazi gjinore për pozitën e gruas në komunën e Malishevës.

Kush është për?

Për: 21

Kundër: 0

Abstenim: 0

Kalojmë në pikën e fundit për çështjen e energjisë elektrike në komunën e Malishevës. Urdhëro, Avdi!

Avdi Morina: Po ju them me shumë siguri të plotë, që ka alternativa që Malishevës t'i zgjidhet ky problem, por duhet të jemi më këmbngulës dhe ndoshta të përdorim metoda të tjera, sepse kjo gjendje është e padurueshme për ne si familjarë, dhe për bizneset që operojnë në komunën e Malishevës. Unë do t'u drejtohem me një kërkesë kryeshefit ekzekutiv të kostit, pra operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike Mustaf Hasanit, dhe e njëjta kopje t'i shkojë dhe kryeministrit në detyrë Abdullah Hotit, ministrit Blerim Kuqi dhe shefit të bordit të kostit Jeton Mehmeti. Komuna e Malishevës dhe qytetarët e saj ka 10 ditë që po ballafaqohen me reduktime të ashpëra me energji elektrike, për shkak të ngarkesës në rrjetin elektrik. Nga këto reduktime dhe energjia elektrike që po u servohet qytetarëve tanë është nën çdo standard të lejuar për ekonominë familjare, dhe gjithë ato biznese prodhuese që operojnë në komunën tonë. Anëtarët e kuvendit komunal në Malishevë, pa dallime politike kërkojnë që të merren masa urgjente në tejkalimin e kësaj gjendjeje, sa i përket furnizimit të rregullt me energji elektrike. Duke i kuptuar mundësitë tuaja të kufizuara, kërkojmë ndonjë mundësi për një kohë kalimtare deri në funksionalizimin e sistemit 220 kilovat, i cili është në procedurë të funksionalizimit të këtij sistemi për komunën e Malishevës. Nëpërmjet kësaj kërkesë, kërkojmë nga ju marjen e masave të menjëhershme për tejkalimin e kësaj gjendjeje, përndryshe jemi të detyruar marrjen e masave të tjera, deri në realizimin e kërkesave tona për furnizim të rregullt me energji elektrike. Unë kërkoj nga ju që ta mbështesim këtë kërkesë. Faleminderit!

Alban Krasniqi: Por, si do ta adresojmë ne si rezolutë, rekomandim, apo kërkesë prej kuvendit që e ka fuqinë më të madhe. Si duam ta emërtojmë, kërkesë prej kuvendit apo kryesuesit? Kuvendi nxjerr rekomandim s'i të dal proceduralisht më mirë. Vetëm edhe një shtesë, që në fund jemi të detyruar që së bashku me qytetarët të ndërmarrim masa.

Rrahim Morina: Kush është që kërkesa për energji elektrike t'u dërgohet organeve relevante në nivel vendi?

Për: 23

Kundër: 0

Abstenim: 0

Faleminderit për pjesëmarrje! Urime Viti I Ri të gjithëve!

Mbledhja përfundoi në ora: 16:10.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Rrahim Morina

